



# RAPORTI I MONITORIMIT PËR VITIN 2020- 2021,

## TË DOKUMENTIT TË POLITIKAVE STRATEGJIKE DHE PLANIT KOMBËTAR TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE 2020-2035

### Shënim i rëndësishëm:

Ky dokument u përgatit nga grupi i punës për mëmonitorimin e zbatueshmërisë së dokumentit të politikave strategjikë dhe planit kombëtar të menaxhimit të integruar të mbetjeve, 2020-2035, me përfaqësues nga të gjithë ministrinë e linjës me mbështjen e Agjencisë Gjermane për Zhvillim dhe grupit të ekspertëve të kontraktuar nga kjo agjenci. Nje falenderim i vecantë i shkon të gjithë autorëve të këtij dokumenti dhe gjithë kontribuesve të cilët furnizuan me informacion dhe diskutime shumë të rëndësishme përgjatë gjithë periudhës së vlerësimit dhe monitorimit.

## PERMBAJTJA

<b>SHKURTIME</b> .....	3
<b>1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b> .....	4
<b>2. HYRJE</b> .....	6
<b>3. GJENDJA E MENAXHIMIT TË MBETJEVE</b> .....	7
<b>4. METODOLOGJIA E MONITORIMIT</b> .....	7
<b>5. REZULTATE TË MONITORIMIT TË SKMIM 2020-2030</b> .....	10
<b>6. ANALIZË E DETAJUAR E PROGRESIT SIPAS TREGUESVE TË MONITORIMIT</b> .....	19
<b>7. PËRFUNDIME</b> .....	63
<b>8. SHTOJCA</b> .....	65

### Kontribues në raport:

#### Autorë të raportit

Z. Mihallaq Qirjo – Ekspertë i Lartë i mjedisit dhe politikave në fushën e Mbetjeve

Znj. Orneta Shapo – Eksperte e lartë e GIZ

#### Grupi Teknik i punës të cilët janë kontribuesit kryesorë të raportit

Z. Redi BADUNI Kryetar, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Znj. Ledjana KARALLIU Anëtar, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Znj. Kiti SHABANAJ Anëtar, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Znj. Desiana TODOLLI Anëtar, Ministria e Drejtësisë

Z. Ruzhdi RUSTEMI Anëtar, Ministria e Mbrojtjes

Z. Isa MEMIA Anëtar, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Z. Alban ISUFI Anëtar, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Z. Hubert TOSHI Anëtar, Ministria e Brendshme

Znj. Zhaneta MISKA Anëtar, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Z. Gersi ÇABIRI Anëtar, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore

## SHKURTIME

AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
AKM	Agjensia Kombëtare e Mjedisit
AKUM	Agjencia Kombëtare e Ujësjetës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve
BE	Bashkimi Evropian
GIZ	Agjencia Gjermane për Zhvillim
INSTAT	Instituti i Statistikave
IPA	Instrumenti i Para-aderimit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MIE	Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MIM	Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve
MPEE	Mbetjet nga Pajisjet Elektrike dhe Elektronike
MTM	Ministria Turizmit dhe Mjedisit
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
O&M	Operimi dhe Mirëmbajtje
OJF	Organizatat Jo Fitimprurëse
PKMIM	Plani Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve
PZP	Përgjegjësia e Zgjeruar e Prodhuarit
RGJM	Raporti i Gjendjes së Mjedisit
RrShTN	Rregjistri i Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve
SKMIM	Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

## 1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Dokumenti strategjik "Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe Plani i Veprimit 2020-2035" i miratuar në maj 2020 vendos piketat strategjike të zgjidhjes së njërës prej problemeve të trashëguara dhe më akutë të vendit tonë, menaxhimin e mbetjeve. Ky raport vlerësimi është dokumenti i parë vlerësues i ecurisë së zbatimit të kësaj strategjie dhe mbulon vitin e parë të zbatimit, qershor 2020-qershor 2021. I mbështetur prej GIZ në kuadër të programit "Menaxhimi dhe riciklimi i mbetjeve të ngurta miqësor me mjedisin në Shqipëri", ky proces synon të vlerësojë efektivitetin e zbatimit të masave të strategjisë, të vlerësojë eficientën e strukturave përgjegjëse menaxhuese, të nxjerrë mësimet si dhe të japë rekomandimet e nevojshme për përmirësimin e mëtejshëm të ecurisë së zbatimit të saj.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit e vlerëson me rëndësi të veçantë zbatimin e kësaj strategjie për të përmbushur objektivat e programit qeverisës së vendit, ndaj është tërësisht e angazhuar në monitorimin në vijimësi të zbatimit të saj dhe vlerësimin vjetor të arritjes së objektivave të përcaktuar. Gjatë këtij vlerësimi janë përfshirë të gjithë institucionet qendrore dhe vendore, të cilat kanë rol në menaxhimin e integruar të mbetjeve, të përcaktuar edhe në SKMIM. Gjatë një periudhe 4 mujore rreth 109 institucione të ndryshme janë përfshirë përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit dhe të pjesëmarrjes për të dhënë të dhëna mbi menaxhimin e mbetjeve dhe informacione rreth proceseve të ndryshme ligjore, rregullatore, kualifikuese dhe ndërgjegjësuese në nivel qendror dhe vendor. Bazuar në të dhënat e grumbulluara prej mbi 61% të institucioneve (por rreth 95% të institucioneve në nivel qendror dhe 75% të NJQV, të cilat janë drejtpërdrejt përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve), gjykojmë se ky raport i parë vlerësues mundëson bazën monitoruese dhe vlerësuese jo vetëm për vitin e parë të zbatimit të SKMIM, por edhe të vijimit të këtij procesi në vitet pasues.

Viti 2020 ka qenë i veçantë për kufizimet e lidhura me masat ndaj pandemisë COVID-19, të cilat kanë pasur ndikimin e tyre edhe mbi zbatimin (efektivitetin dhe eficientën e ndërhyrjeve në menaxhimin e mbetjeve).

Gjatë vitit 2020, në nivel vendi trajtohen dhe përpunohen 70% e sasisë së gjeneruar të mbetjeve. Sasia e grumbulluar e mbetjeve vlerësohet në rreth 900 mijë ton mbetje të ngurta. Raportohet se gjatë vitit 2020 në impiantet rajonale të depozitimit përfundimtar të mbetjeve janë depozituar rreth 430 mijë Ton (ose 51% e mbetjeve të grumbulluara në të gjithë vendin). Një pjesë e mirë e mbetjeve që grumbullohen në të gjithë territorin e vendit nga bashkitë, vijon të hidhen në mënyrë të pakontrolluar në vend depozitime bashkiake të cilat nuk plotësojnë kushtet minimale sanitare të përcaktuar nga ligji. Të dhënat në nivel vendor vlerësohen të pjesshme, meqë vetëm 41% e Bashkive i peshojnë mbetjet që grumbullojnë në territorin e tyre, nga 30% që kryenin këtë proces në vitin 2019.

Nga të dhënat e këtij vlerësimi 54 Bashki deklarojnë sipas standardit të miratuar, por ndëkohë vetëm 58% e bashkive kanë sistem të grumbullimit të të dhënave lidhur me menaxhimin e mbetjeve. Ndërkohë, 27 Bashki (ose 44% e totalit të Bashkive) kanë raportuar se kanë PVMIM, që përbën 90% të objektivit të vitit 2025. Mesatarja e mbulimit të popullsisë në nivel vendi për vitin 2020 është 78% dhe mbulimi i territorit në nivel Bashkie është 81%. Rikuperimi dhe riciklimi mbeten në nivele shumë të ulta me 1-3%, ku sasinë më të madhe e zënë mbetjet plastike me 8%.

Prej 199 vend depozitimeve të identifikuara në vitin 2018, gjatë 2020 janë kryer punime rehabilituese të plota në 9 prej tyre, duke pasur një ecuri të ngadaltë drejt përmbushjes së objektivit për sistemimin, rehabilitimin dhe mbylljen e plote të tyre deri në vitin 2025.

Niveli i financimit të sektorit të menaxhimit të integruar të mbetjeve ka kapur shifrën e mbi 7 miliardë Lekë, duke përfshirë financimin nga buxheti i shtetit (Qeverisja Qendrore), buxhetet në nivelin vendor (Qeverisja Vendore) dhe ndihma e huaj. Gjatë këtij viti ka pasur sërish rritje të financimit prej buxhetit në nivelin vendor në masën prej +22% krahasuar me 2019, por në pak raste referohet përmirësim i cilësisë së shërbimit apo zgjerim i mbulimit me të. Ndërkohe Bashkitë referojnë se arrijnë të grumbullojnë tarifën e pastrimit në masën 60%.

Gjatë 2020 nuk ka pasur progres lidhur me menaxhimin e rrymave të ndryshme të mbetjeve, për të cilat nuk ka të dhëna prej nivelit vendor, meqë në shumicën e rasteve referohet se mbetjet nuk ndahen, nuk peshohen dhe mungon sistemi MIM. Vetëm për mbetjet spitalore jepen të dhëna mbi sasinë e grumbulluara dhe të trajtuara prej sistemit të insitucioneve shëndetësore publike dhe atyre private. Gjatë vitit 2020, janë grumbulluar 811,626 kg mbetje spitalore (ose 16.9% më shumë se në vitin 2019) dhe janë trajtuar 787,470 Kg (ose +13.7% krahasuar me 2019). Ndikim të veçantë në rritjen e sasisë ka pasur edhe gjendja e pandemisë COVID-19 që ka shtuar sasinë e grumbulluara dhe të trajtuara të mbetjeve spitalore.

Referuar objektivit të vitit 2025 për të pasur raportim prej të gjithë prodhuesve dhe zbatimin e detyrimit të tyre për të ndarë mbetjet e rrezikshme që në burim, kërkohet të bëhet funksional sistemi i raportimit prej të gjithë kompanive pranë AKM, e cila përveç rregjistrit të kompanive që prodhojnë, transportojnë apo përpunojnë mbetje të rrezikshme mban edhe rregjistrin e inventarit të këtyre lloj mbetjesh.

Procesi i vlerësimi të ecurisë së zbatimit të SKMIM duhet të vijojë në vitet e ardhshme si një mundësi jo vetëm për shqyrtimin e arritjes së objektivave të përcaktuara, por edhe të marrjes së masave të hershme për modifikime apo ndryshime të masave apo të treguesve të performancës, në mënyrë që të rritet efektiviteti dhe efienca e ndërhyrjeve dhe e fondeve të alokuara për këtë sektor.

## 2. HYRJE

Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe Plan i Veprimit u miratua me VKM në 27 maj 2020. Zhvillimi i këtij dokumenti të rëndësishëm strategjik për vendin synon të japë zgjidhje për një prej problemeve të trashëguara dhe më akutë të vendit tonë, menaxhimin e mbetjeve. Kjo çështje vlerësohet me rëndësi të veçantë jo vetëm kundrejt detyrimeve për mbrojtjen e mjedisit nga ndotja dhe mirë menaxhimin e burimeve të vendit, por edhe si një ndër drejtimet prioritare të Kapitullit 27, në procesin e negociatave për integrimin në BE të vendit tonë. Rruga e hartimit të këtij dokumenti, mbështetur prej GIZ, përshkoi një diskutim të gjerë me aktorët kryesorë të menaxhimit të mbetjeve në vend, si në nivelin kombëtar ashtu edhe atë vendor, me qëllim për të adresuar këtë problem përmes zgjidhjesh të qëndrueshme afatgjata.

Procesi i vlerësimit të ecurisë së zbatimit është parashikuar në këtë strategji në afate kohore 5 vjeçare në periudhën 2020-2035 përmes një numri treguesish progresi të matshëm. Meqë ky proces ka ndodhur për herë të parë në vendin tonë, vlerësimi i ecurisë në mënyrë të vazhduar është një proces i domosdoshëm për të përshtatur dhe modifikuar në kohë ndërhyrjet e parashikuara në masat e strategjisë, në mënyrë të të arrihen objektivat e parashikuar.

Drejtimi nga MTM i Grupit Teknik për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, i përbërë nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme qendrore dhe vendore, të shoqërisë civile dhe agjencive mbështetëse synon jo vetëm harmonizimin e përpjekjeve dhe veprimeve ndërhyrëse, por edhe grumbullimin e të dhënave të nevojshme rreth gjendjes dhe efektivitetit të ndërhyrjeve në rajone të ndryshme gjeografike dhe për rryma të caktuara të mbetjeve.

Ky raport vlerësimi është dokumenti i parë vlerësues në kuadër të këtij procesi të gjerë vlerësues, i cili synon të:

1. vlerësojë efektivitetin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe Planin Kombëtar të Veprimit 2020-2035, i fokusuar në masat dhe përmbushjen e treguesve përgjatë vitit 2020, si viti i zbatimit të kësaj Strategjie.
2. vlerësojë efikasitetin e strukturave përgjegjëse menaxhuese për zbatimin e masave të miratuara në këtë dokument strategjik.
3. nxjerrë mësim dhe japë rekomandimet e nevojshme për përmirësimin e mëtejshëm të ecurisë së zbatimit.

### 3. GJENDJA E MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Menaxhimi i mbetjeve është një nga përparësitë kryesore të deklaruara nga Qeveria e Shqipërisë, e cila synon të vijojë ta trajtojë këtë temë edhe në vitet e ardhshme. Në këtë drejtim, Shqipëria ka ndërmarrë hapa të mirë në transpozimin e legjislacionit të BE-së dhe posaçërisht në nënkapitullin e menaxhimit të mbetjeve, ku niveli i transpozimit të akteve ligjore është rreth 53,5%<sup>1</sup>, por megjithatë, zbatimi i këtij legjislacioni është i mangët në disa komponentë, ndërsa në disa të tjerë, është ende në fazën fillestare.

Pavarësisht se Shqipëria ka përmirësuar legjislacionin për mjedisin dhe në mënyrë të veçantë atë për menaxhimin e mbetjeve, zbatimi i tij për këtë sektor mbetet ende një sfidë. Problemet lidhen kryesisht me shtrirjen e pjesshme të shërbimit në territor, grumbullimin dhe depozitimin e pamjaftueshëm të mbetjeve, sasinë e kufizuar që depozitohet dhe trajtohet në vend depozitime, praninë e një numri të madh të lëndfilleve (të autorizuara dhe të paautorizuara), të cilat janë jashtë standardeve higjienike dhe inxhinierike, numri i kufizuar dhe cilësia e dobët e pajisjeve për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve, mungesa e ndarjes së mbetjeve në burim dhe përqindja e ulët e riciklimit, mungesa e infrastrukturës për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Referuar të dhënave nga Agjencia Kombëtare e Mjedisin në Raportin e Gjendjes së Mjedisit 2020, në nivel vendi trajtohen dhe përpunohen 70% e sasisë së gjeneruar të mbetjeve<sup>2</sup>. Në RGJM, raportohet se gjatë vitit 2020 në këto impiante rajonale të depozitimit përfundimtar të mbetjeve janë depozituar rreth 430 mijë Ton (ose 51% e mbetjeve të grumbulluara në të gjithë vendin). Një pjesë e mirë e mbetjeve që grumbullohen në të gjithë territorin e vendit nga bashkitë, vijon të hidhen në mënyrë të pakontrolluar në vend depozitime bashkiake të cilat nuk plotësojnë kushtet minimale sanitare të përcaktuar nga ligji. Të dhënat në nivel vendor vlerësohen të pjesshme, meqë vetëm 41% e Bashkive i peshojnë mbetjet që grumbullojnë në territorin e tyre, nga 30% që e kryenin këtë proces në vitin 2019.

SKMIM referon vitin 2019 si vitin bazë për monitorimin e ecurisë së zbatimit të saj. Sipas të dhënave të INSTAT për vitin 2019, shërbimi është ofruar për 87,9% të popullsisë, ose për 2.508.834 banorë, nga totali i popullsisë së vendit prej 2.854.191 banorësh. Rreth 18,7% e sasisë së përgjithshme të mbetjeve, por të dhënat për rikuperimin dhe riciklimin janë të mangëta.

### 4. METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Metodologjia e vlerësimit të ecurisë në zbatimin e SKMIM dhe PKV 2020-2035 është bazuar në objektivat e vendosur për këtë proces me qëllim shqyrtimin e shkallës së progresit kundrejt objektivave afat shkurtër për vitin 2025. Procesi i vlerësimit ka ndjekur një metodikë standarte të vlerësimit bazuar në metodën krahasimore të rezultateve të grumbulluara për vitin 2020, si viti i parë i zbatimit të SKMIM kundrejt të dhënave të referuara për vitin bazë 2019.

<sup>1</sup> "Raporti përgatitor i vlerësimit", përgatitur në kuadër të projektit SANE27

<sup>2</sup> [http://www.akm.gov.al/assets/rqjm\\_2020.pdf](http://www.akm.gov.al/assets/rqjm_2020.pdf)

Metodologjia e grumbullimit dhe e përpunimit të informacionit është dakortësuar paraprakisht me Grupin Teknik në një takim prezantues në muajin prill 2021. Ajo ka ndjekur ndjekur tre rrugë për grumbullimin e të dhënave sipas treguesve të performancës të përcaktuar në strategji për secilën masë:

- përmes pyetesorëve specifikë sipas rolit të përcaktuar për institucionet qendrore, njësitë e qeverisjes vendore, OJFtë dhe institucionet akademike
- përmes intervistave gjysëm të strukturuar me programe dhe agjenci të mbështetjes së huaj në sektorin e menaxhimit të mbetjeve
- përmes studimeve dhe materialeve të botuara nga burime zyrtare të informacionit dhe raporte te teknike të sektorit të menaxhimit të mbetjeve

Grumbullimi i të dhënave është kryer në periudhën Prill – Qershor 2021. Vlerësimi i ecurisë nuk ka kryer verifikime në terren të veprimtarive të raportuara, por ka përfshirë të dhëna prej të gjitha agjencive mbështetëse, të cilat kanë monitoruar nga afër zbatimin përmes stafëve vendore në Bashki të ndryshme.

Në përfundim të procesit të grumbullimit të të dhënave, është grumbulluar informacioni i nevojshëm për të kryer vlerësimin e ecurisë së strategjisë. Për tregues të veçantë për të cilës nuk ka pasur të dhëna apo nuk është kryer raportimi, vlerësimi sasior dhe cilësor ka qenë i pamundur, duke mundësuar dhënien e rekomandimeve për tu plotësuar në vitet më pas.

Institucione	Niveli qendror	Agjenci kombëtare	Niveli vendor	Programe të mbështetjes së huaj	Institucione Akademike	OJF	Biznese
Kontaktuar:	6 (takime, pyetësorë)	4 (takime, studime, pyetësorë)	61 (pyetësorë)	4 (takime, studime)	4 (pyetësorë)	20 (pyetësorë)	10 (pyetësorë)
Përgjigjur	5	3	37	3	4	8	1
Niveli i përfshirjes	83%	75%	61%	75%	100%	40%	10%




Nën drejtimin e MTM, Grupi Teknik i Ekspertëve ka realizuar disa takime ndërmjetëse në periudhën Prill – Korrik 2021, për të vlerësuar ecurinë e grumbullimit të të dhënave dhe një takim përmbledhës për diskutimin e gjetjeve të vlerësimit të ecurisë së zbatimit të strategjisë.

Analiza e të dhënave të grumbulluara është bazuar në metodën krahasimore, ku mesatarja e thjeshtë e të dhënave të referuara mbi realizimin për vitin e parë të zbatimit të SKMIM, për vitin 2020, kundrejt vitit bazë të krahasimit 2019, është krahasuar me vlerën e treguesit për vitin 2025 si objektivi i dëshiruar. Në rastet kur objektivi për vitin 2025 është i specifikuar vetëm si tregues cilësor ose mungon, atëherë vlerësimi është kryer duke ju referuar objektivave më afatgjatë dhe ecurisë së ndodhur gjatë vitit 2020.

Validimi i të dhënave të grumbulluara lidhur me sasitë e grumbulluara të mbetjeve në nivel vendor është kryer duke krahasuar dhe vlerësuar saktësinë e të dhënave të referuara nga disa burime paralele. Analiza e vlerësimit e shprehur në pikë përqindjeje është grupuar në tre fasha realizimi si në tabelën më poshtë.







Për lehtësi vlerësimi vizual janë përdorur tre skica emoji dhe ngjyra të ndryshme për të shprehur shkallën e përmbushjes së objektivave:





0-10%	10-20%	20-30%	30-40%	50-60%	60-75%	75-85%	85-100%
Përkeqësim i situatës Mungesë progresi, Ecuri e pakënaqshme			Ecuri sipas parashikimit		Ecuri e kënaqshme Ecuri e mirë ose shumë e mirë		
							








Procesi i grumbullimit të të dhënave dhe ushtrimi validues i të dhënave të grumbulluara nga burime të ndryshme u mbështet tërësisht nga përfaqësues të MTM, programit të GIZ dhe pjesëtarë të agjencive të ndryshme pjesëmarrëse në Grupin Teknik të Ekspertëve.

## 5. REZULTATE TË MONITORIMIT TË STRATEGJISË KOMBËTARE TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE 2020-2030









Tabelë përmbledhëse






Masa	Treguesi	Vlerësimi i progresit	
		sasior	cilësor
<b>QËLLIMI STRATEGJIK:</b> Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve duke përfshur parimet kryesore dhe kërkesat ligjore të planifikimit			
<b>Objektivi strategjik 1:</b> Planifikimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve bëhet në bazë të zonave të mbetjeve duke ofruar shërbim për të gjithë popullatën			
M1. Ngritja e sistemit të dokumentimit, informimit dhe performancës të statistikave të gjenerimit, transferimit dhe trajtimit të mbetjeve në nivel kombëtar dhe vendor	T1: Numri i Bashkive dhe gjeneruesve të mbetjeve që raportojnë të dhënat sipas sistemit	65.6% (+24.6% ▲ me 2019)	
M2. Studimet e fizibilitetit janë përgatitur për të gjitha Zonat e Menaxhimit të Mbetjeve duke siguruar një program të optimizuar për financimin dhe zbatimin e Rrjetit të Integruar të Objekteve për Menaxhimin e Mbetjeve	T2: Numri i studimeve të fizibilitetit për zonat e mbetjeve	37.5% (+37.5% ▲ me 2019)	
M3. Bashkitë kanë zhvilluar dhe miratuar në Këshillat Bashkiakë Planet Vendore për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (PVMIM), në përputhje me Dokumentin e Politikave Strategjike Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe Planin Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta	T3: Numri i bashkive që kanë një PVMIM të miratuar	60% (+10% ▲ me 2019)	
	T4: % e projekteve të Materplanit të financuara	3 projekte	






OBJEKTIVI STRATEGJIK 2: Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve ka mundësuar grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve në mënyrë të integruar në përpunime me standardet e BE				
M4. Bashkitë mbulojnë gjithë territorin e tyre administrativ me shërbime që përmbushin standardet minimale të përcaktuara	T5: % e mbulimit me shërbim e shprehur si numër eqv. banorësh që marrin shërbim / nr. eqv. të banorëve rezidentë	100%		
	T6: % sasisë së mbetjeve të grumbulluara / sasia e mbetjeve të gjeneruara (sipas planifikimit)	841,328 ton të grumbulluara (+48 808 ton ▲; 63%)		
M5. Të gjitha Bashkitë e vendit kanë ndërtuar skemën e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve bazuar në efektivitetin dhe efikasitetin më të mirë financiar dhe standardet minimale sektoriale sipas normave të drektivave përkatëse të transpozuar në ligjin shqiptar	T7: % e popullatës, mbuloheh me shërbimin e MIM.	Nuk mund të vlerësohet		
	T8: % e popullatës në qytete me më shumë se 100,000 banorë, (zonat urbane) mbuloheh me shërbimin e MIM	Nuk mund të vlerësohet		
	T9: % e sasisë së mbetjeve (për secilën rrymë) që shkon për riciklim/sasisë totale të mbetjeve të gjeneruara në ton/vit	Nuk mund të vlerësohet		
	T10: % e mbetjeve të tjera të rikuperuara nga mbejjet mikse bashkiake kundrejt totalit të mbetjeve nga paketimi të rikuperueshme	Nuk mund të vlerësohet		
	T11: % e sasisë së mbetjeve të paketimit që rikuperohen në nivel bashkie kundrejt totalit të gjeneruar	Nuk ka progres		
	T12: % e sasisë së mbetjeve që depozitohet në landfill ose	+45%		

	venddepozitime/ sasia totale e mbetjeve të grumbulluara ton/vit		
	T13: Nr. i qendrave pritëse ose formate të tjera të ngritura nga bashkitë për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve nga prishjet dhe ndërtimet	Nuk ka progres	
	T14: Numri i sistemeve të depozitimit dhe trajtimit të mbetjeve të ngritura në zbatim të hierarkisë së mbetjeve	66%	
M6. Në të gjithë territorin janë trajtuar dhe mbyllur sipas udhëzimeve në fuqi të gjitha vend-depozitimet bashkiake historike të mbetjeve	T15: Numri i venddepozitimeve historike të trajtuara dhe/ose mbyllura kundrejt numrit total të venddepozitimeve historike, në nivel bashkie.	17%	
M7. Bashkitë në zonat e impianteve të mbetjeve-për energji dërgojnë mbetjet e tyre të pariciklueshme dhe mbetjet e përziera në këto impianteve	T16: Numri i bashkive që dërgojnë mbetjet e pariciklueshme dhe të përziera në impiantet me WtE	33%	
	T17: Sasia e mbetjeve që shkon për rikuperim energjie /sasia totale e mbetjeve në vit	17.5%	
M8. Skema kombëtare e Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit zbatohet për paketimet dhe mbetjet nga pakëtimi	T18: % e mbetjeve nga paketimet të grumbulluar nga skemat e Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit	Nuk ka progres	
<b>OBJEKTIVI STRATEGJIK 3: Krijimi i një sistemi për menaxhimin e integruar të trymave të tjera të mbetjeve jo-bashkiake, i cili bazohet në hierarkinë e mbetjeve</b>			
M9. Qeveria qendrore në zbatim të parimit "përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit" dhe/ose në partneritet me biznesin	T19: Numri i planeve të fizibilitetit kundrejt numrit të zonave	Nuk ka progres	








<p>harrtojnë planet e fizibilitetit të zonave të mbetjeve, me qëllim ngritjen e sistemet e përbashkëta dhe të veçanta të grumbullimit dhe të trajtimit të mbetjeve specifike si për gomat, bateritë, mbetjeve elektrike dhe elektronike, mbetjet organike, makinat në fund të jetës, etj</p>	<p>T20: % e baterive dhe akumulatorëve dërgohen në qendrat e pritjes dhe tërhiqen nga bizneset e licensuar</p> <p>T21: % e llumrave në impiantet e trajtimit të ujërave të përdorur trajtohen pranë impianteve</p> <p>T22: % e mbetjeve inerte që grumbullohen kalojnë në impiantet e trajtimit dhe ripërdoren</p>	<p>Nuk mund të vlerësohet</p> <p>Nuk mund të vlerësohet</p> <p>Nuk ka progres</p>	<p>Nuk mund të vlerësohet</p>
<p>M10. Ministria përgjegjëse për Mjedisin në bashkëpunim me institucionet e tjera të ngarkuara me ligj për mbetjet, harton politika kombëtare që janë të aplikueshme në nivelin e Zonës së Mbetjeve dhe bashkëpunon me bashkitë të qëndrueshëm të mbetjeve të rrymave specifike në zbatim të hierarkisë së mbetjeve, për mbetjet bashkiake, jo bashkiake dhe mbetjet inerte nga ndërtimi dhe prishjet</p>	<p>T23: Kuadri ligjor, rregullator dhe standardet e shërbimit dhe të menaxhimit të mbetjeve specifike janë hartuar</p>	<p>Ka progres</p>	<p>Nuk ka progres</p>
<p>M11. Të gjitha bizneset që importojnë apo prodhojnë mbetje të rrymave specifike, në zbatim të parimit "të përgjegjësishë së zgjeruar të prodhuesit", ngrënë skemat e veçanta dhe/ose të përbashkëta në bashkëpunim me Bashkitë e vendit dhe përdorues të tjerë të mbetjeve specifike si për gomat, bateritë, mbetjeve elektrike dhe elektronike, mbetjet organike, makinat në fund të jetës, etj., për rikuperimin dhe trajtimin e tyre</p>	<p>T24: Numri i skemave funksionale për rikuperimin dhe trajtimin e mbetjeve specifike</p>	<p>Nuk ka progres</p>	<p>Nuk ka progres</p>
<p><b>QËLLIMI STRATEGJIK 2: Përmirësimi dhe harmonizimi i kuadrit ligjor të menaxhimit të mbetjeve</b></p>			
<p><b>OBJEKTIVI STRATEGJIK 4: Kuadri ligjor i menaxhimit të mbetjeve është përmirësuar dhe harmonizuar me direktivat evropiane dhe është ngritur një sistem institucional efikas në nivel kombëtar</b></p>			
<p>M12 Autoritetet qendrore në bashkëpunim të ngushtë me pushtetin vendor kanë rishikuar legjislacionin në fuqi për menaxhimin e mbetjeve</p>	<p>T25: % e legjislacionit të rishikuar në zbatim të reformimit të parashikuar nga Dokumenti i Politikave Strategjike</p>	<p>Ka progres</p>	<p>Nuk ka progres</p>








M13 Ligji ka parashikuar role dhe përgjegjësi institucionale të qarta për njësitë e qeverisjes qendrore dhe të qeverisjes vendore dhe institucionet e tjera, përfshirë edhe ato rajonale të cilat janë ngarkuar me funksione mbështetëse për menaxhimin e mbetjeve	T26: % e legjislativitetit të rishikuar për të ndarë qartësisht përgjegjësitë dhe rolet e institucioneve të përfshira në menaxhimin e mbetjeve	Ka progres	
M14 Nevoja e rivlerësimit për të siguruar një sistem të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve	T27: Kryerja e vlerësimit për riorganizimin e sistemit të menaxhimit të integruar të mbetjeve	Nuk ka progres	
M15 Bashkitë miratojnë rregulloret e menaxhimit të integruar, në përputhje me udhëzimet e nxjerra	T28: Nr. Bashkive që kanë një rregullore për MIM / numri total i bashkive	Progres i kufizuar	
<b>QELIMI STRATEGJIK 3: Financimi i qëndrueshëm i menaxhimit të mbetjeve</b>			
<b>OBJEKTIVI STRATEGJIK 5: Burimet financiare për menaxhimin e integruar të mbetjeve parashikohen në planifikimin buxhetor afatmesëm të miratuar me ligj</b>			
M16/1: Strukturat përgjegjëse për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve përgatisin udhëzuesin për llogaritjen e kostove dhe të tarifave për shërbimet bashkiake të mbetjeve të ngurta	T29: % totale e financimit të Dokumentit të Politikave Strategjike nga buxheti i brendshëm (PBA) / kundrejt nevojës për financim në nivelin e ZMM për fazë (transferim dhe trajtim)	2-22 herë më shumë se 2019, por e papërcaktuar lidhur me objektivin 2025	
M16/2 Bashkitë në bashkëpunim me pushtetin qendror përcaktojnë nevojat buxhetore për ciklin të plotë të menaxhimit të mbetjeve dhe tarifat për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve, në përputhje me parimin "ndotësi paguan" dhe parimet e "vetë-mjaftueshmërisë"	T30: % e buxhetit të alokuar nga bashkitë kundrejt nevojës për financim	Ka progres të pjesshëm	
	T31: % e shumës së të ardhurave nga tarifa kundrejt kostos totale të shërbimit	Ka progres	
	T32: % e tarifës së mbledhur kundrejt planifikimit	Ka progres	
M17 Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Mbetjeve lehtëson marrëveshjet e financiare në nivelin e ZMM për Bashkitë	T33: Bashkitë mbulojnë koston për transportin dhe trajtimin e mbetjeve në objektet e trajtimit dhe depozitimit final	Nuk ka progres	

dhe autoritetet menaxhuese të njëjste për transferimin dhe trajtimin e mbetjeve	T34: Bashkë mbulojnë koston për transportin dhe trajtimin e mbetjeve në ÈtE	Nuk vlerësohet
M18 Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Mbetjeve mbikëqyr dhe monitoron financat që lidhen me ndërtimin ose modernizimin dhe përmirësimin e infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve	T34: Buxheti i shtetit ka planifikuar dhe financon investimet për infrastrukturën e transportit dhe trajtimin të mbetjeve	Progres i kënaqshëm 
M19. Ministria përgjegjëse për mjedisin propozon llojet e të ardhurave nga taksat për kategori të ndryshme produkteve të tregut shqiptar dhe i përdor këto fonde për të promovuar zvogëlimin e sasisë së mbetjeve, ripërdorimin dhe riciklimin e tyre	T36: MTM koordinon Fondin për Menaxhimin e Mbetjeve, nëpërmjet hartimit të kuadrit ligjor për përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit dhe vënien në zbatim të tij	Nuk ka progres 
<b>OBJEKTIVI STRATEGJIK 6: Menaxhimi i mbetjeve është prioritet kombëtar dhe pjesë e rëndësishme e planifikimit të fondeve të ndihmës së huaj, IFI dhe BE nëpërmjet fondeve IPA</b>		
M20. Qeveria e Shqipërisë alokon jo më pak se 10% të fondeve të saj vjetore, të dhuruara për menaxhimin e mbetjeve nga institucionet ndërkombëtare dhe donatorët e tjerë	T37: % e ndihmës së përfutur / kundrejt totalit të ndihmës së huaj	Progres i kënaqshëm 
M21. Është kryer planifikimi i detyruar dhe janë zhvilluar procedurat për hartimin dhe miratimin e projekteve në sektorin e menaxhimit të mbetjeve që kërkojnë financime publike dhe mbështetje nga donatorët	T38: % e investimeve në sektor / kundrejt parashikimit vjetor sipas Dokumentit të Politikave Strategjike dhe Master Planit	Progres në vijimin e zbatimit të programeve ekzistuese 
<b>QELIMI STRATEGJIK 4: Burimet njerëzore, ndërgjegjësimi dhe pjesëmarrja e popullatës në menaxhimin e mbetjeve</b>		
<b>OBJEKTIVI STRATEGJIK 7: Burimet njerëzore dhe pjesëmarrja</b>		
M22. Institucionet përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve kanë përfshirë në strukturën e tyre njësitë e planifikimit dhe të menaxhimit të mbetjeve me personel të kualifikuar	T.39: Numri i personelit administrativ të punësuar me kohë të plotë për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në të gjithë vendin	Ka progres +13% rritje e numrit krahasuar me 2019 

M23. Krijohet sistemi i kurrikulës së kualifikimit. Paketa e trajnimit të vazhduar e ofruar prej QKEV dhe ASPA, së bashku me personelin teknik përkatës do të vlerësohen me kredite vjetore për aftësitë e fituara	T.40: % e personelit të specializuar që trajnohet në vit	Ka pak progres	
	T.41: Nr. i trajnimeve në vit për institucionet publike apo private që gjenerojnë mbetje të rrezikshme	Nuk ka progres	
M24. Në universitete zhvillohet ekspertize për "green procurement"	T.42.1: Nr. i trajnimeve periodike për kompanitë që trajtojnë mbetjet të rrezikshme	Nuk vlerësohet	
	T.42.2: % (numri i të trajnuarve në planifikim urban/numrit të diplomuarve në inxhinieri)	Progres i kënaqshëm	
<b>OBJEKTIVI STRATEGJIK 8: Qytetarët përdorin dhe respektojnë infrastrukturën e mbetjeve dhe bëjnë pjesë e masave për përmbushjen e objektivave të planeve vjetore</b>			
M25. Qytetarët janë të përfshirë dhe konsultohen për hartimin e Planeve të Menaxhimit të Mbetjeve	T.43: % (numri) i planeve të hartuara me pjesëmarrje komunitare /totalit të planeve të miratuara	62%	
	T.44: % (numri i banorëve që ndajnë mbetjet në burim/kundrejt popullsisë së mbuluar me shërbim të diferencuar)	Nuk vlerësohet	
M26. Bashkitë organizojnë fushata të përvitshme të ndërgjegjësimit "Let's do It" që nxisin sjellje të përgjegjshme mjedisore për reduktimin, ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve	T.45: Nr. i bashkive që organizojnë veprimtari ndërgjegjësimi dhe pastrimi / kundrejt totalit të bashkive	70%	
	M27. Kurse dhe materiale edukuese duhet të shpërndahen nëpër shkolla në të gjithë vendin duke organizuar orë mësimore dhe aktivitete edukuese për nxënësit	T.46: % (numri i shkollave që e kanë/aplikojnë në kurrikull edukimin për mbetjet	Nuk vlerësohet



	T.47: % (numri i shkollave që e kanë/aplikojnë ndarjen e mbetjeve në burim	Nuk vlerësohet	
<b>QELIMI STRATEGJIK 5</b> Janë ngritur instrumentat ligjorë, institucionale dhe financiare për të përmirësuar menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme			
<b>OBJEKTIVI STRATEGJIK 9</b> Janë identifikuar të gjitha rrymat e mbetjeve të rrezikshme që janë prodhuar apo prodhohen në territorin e vendit nga sektori publik dhe ai privat			
M28. Hartimi i një sistemi të dhënash për mbetjet e rrezikshme (inventarizimi i mbetjeve të trashëguara nga industritë ekzistuese, nga industritë që gjenerojnë sot mbetje të rrezikshme)	T.48: % e institucioneve/bizneseve që gjenerojnë mbetje të rrezikshme që informojnë sipas kategorive dhe formatit të mbetjeve, të identifikuar	Nuk ka progres	
M29. Hartimi i Master Planit për rryma të veçanta mbetjesh përfshirë mbetjet e rrezikshme	T.49: Plani kombëtar për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme është hartuar	Nuk ka progres	
M30. Janë hartuar dhe zbatohen udhëzimet, protokollet, standardet dhe programet e trajnimit për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme	T.50: % e mbetjeve minerare të grumbulluara dhe të trajtuara kundrejt totalit të kësaj kategorie të gjeneruar	Nuk ka progres	
	T.51: % e mbetjeve kimikate të grumbulluara dhe të trajtuara kundrejt totalit të kësaj kategorie të gjeneruar	Nuk ka progres	
	T.52: % e mbetjeve bujqësore dhe drurit të grumbulluara dhe të trajtuara kundrejt totalit të kësaj kategorie të gjeneruar	Nuk ka progres	
	T.53: % e mbetjeve nga gomat të grumbulluara dhe të trajtuara kundrejt totalit të kësaj kategorie të gjeneruar	Nuk ka progres	
	T.54: % e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike të grumbulluara dhe të	Nuk ka progres	

	Trajtuara kundrejt totalit të kësaj kategorie të gjeneruar		
	T.55: % e mbetjeve nga llumi i impianteve të grumbulluara dhe të trajtuara kundrejt totalit të kësaj kategorie të gjeneruar	-46.8 ton (-87%) më pak se 2019	
	T.56: % e mbetjeve nga produktet e kafshëve të grumbulluara dhe të trajtuara kundrejt totalit të kësaj kategorie të gjeneruar	Nuk ka progres	
	T.57: % e mbetjeve vajra të grumbulluara dhe të trajtuara kundrejt totalit të kësaj kategorie të gjeneruar	Nuk ka progres	
	T.58: % e mbetjeve nga bateritë dhe akumulatorët të grumbulluara dhe të trajtuara kundrejt totalit të kësaj kategorie të gjeneruar	Nuk ka progres	
	T.59: % e mbetjeve spitalore të grumbulluara dhe të trajtuara kundrejt totalit të kësaj kategorie të gjeneruar	+33.8 krahasuar me 2019	
M31. Prodhuetit e mbetjeve të rrezikshme sigurojnë se menaxhimi i mbetjeve të rrezikshme bëhet në përputhje me kërkesat ligjore dhe udhëzimet në fuqi dhe zbatojnë ndarjen e mbetjeve të rrezikshme nga ato të parrezikshme	T.60: Nr. i kompanive që gjenerojnë dhe trajtojnë mbetje të rrezikshme që raportojnë rregullisht në RrSH TN kundrejt totalit të tyre në vend	Nuk ka progres	
	T.61: % e mbetjeve të rrezikshme që ndahen nga mbetjet e parrezikshme	Nuk ka progres	

## 6. ANALIZË E DETAJUAR E PROGRESIT SIPAS TREGUESVE TË MONITORIMIT

Në pjesën vijuese paraqitet progresi në zbatimin e strategjisë sipas Masave dhe treguesve përkatës. Të dhënat e grumbulluara sipas metodikës së monitorimit kanë mundësuar formimin e opinionit vlerësues në aspektin sasior dhe/ose cilësor.

**QËLLIMI STRATEGJIK 1: PËRMIRËSIMI I MENAXHIMIT TË MBETJEVE DUKE PËRMBUSHUR PARIMET KRYESORE DHE KËRKESAT LIGJORE TË PLANIFIKIMIT.**


**OBJEKTIVI STRATEGJIK 1: PLANIFIKIMI DHE MENAXHIMI I INTEGRUAR I MBETJEVE BËHET NË BAZË TË ZONAVE TË MBETJEVE DUKE OFRUAR SHËRBIM PËR TË GJITHË POPULLATËN**

**M1. Ngritja e sistemit të dokumentimit, informimit dhe performancës të statistikave të gjenerimit, transferimit dhe trajtimit të mbetjeve në nivel kombëtar dhe vendor**

Nga 37 Bashki (ose 60.6 % të totalit) i janë përgjigjur pyetësorit duke referuar se vetëm 14 Bashki (37.8% të përgjigjeve ose 23% e totalit) kanë ngritur sistemin e grumbullimit të të dhënave për menaxhimin e mbetjeve në nivel vendor dhe referimin e tyre në sistemin kombëtar të të dhënave për menaxhimin e mbetjeve. Bashkitë që referojnë një sistem të ngritur nuk kanë përjasje me ngritjen e infrastrukturës fundore në përpunimin e mbetjeve, duke u ndarë në 42% të Bashkive që kanë sistem të grumbullimit të të dhënave dhe infrastrukturën fundore kundrejt 58% të Bashkive që kanë sistem të grumbullimit të të dhënave, por jo infrastrukturë fundore të ngritur dhe funksionale. Pothuaj të gjitha Bashkitë referojnë problematike të dhënat sipas rrymave të mbetjeve për shkak të mos ndarjes dhe peshimit të tyre.

Ndërkohë AKM, në Raportin për Gjendjen e Mjedisit 2020, raporton se 54 Bashki deklarojnë sipas standardit të miratuar. AKM ka në proces ngritjen e një sistemi, ku është finalizuar një modul i veçantë për raportimin e mbetjeve nga Bashkitë.

AKM raporton se ende nuk ka përfunduar trajnimi i stafit të bashkive që merret me raportimin e informacioneve për mbetjet. AKM raporton vështirësi në marrjen e informacionit nga bashkitë për shkak të kapaciteteve të kufizuara siç është mungesa e personave të kontaktit për raportimin e sasive të mbetjeve. AKM vëren probleme në raportim në respektimin e njësisë matëse, mungesën e të dhënave për rubrikat e përcaktuara dhe ndarjen në përqindje sipas përbërjes së mbetjeve.



*\*) vlerë e ekstrapoluar kundrejt totalit të Bashkive (=61)*

### Vlerësimi në përmbushjen e objektivit

Referuar vitit 2019 si vit krahasimor ku referohen 25 bashki, kundrejt 40 të raportuar nga AKM që kanë filluar raportimin sipas formatit të sistemit kombëtar (krahasuar me 34 bashki që janë përgjigjur kundrejt totalit prej 61 bashkish) si vlerë e ekstrapoluar e përgjigjeve kundrejt totalit prej 61 bashkish) vlerësojnë se ka progres drejt përmbushjes së objektivit për raportimin e 61 Bashkive deri në vitin 2025.

Treguesi nr. 1	Viti 2019	Objektivi 2025	Realizimi 2020	Vlerësimi për vitin 2020 krahasuar me objektivin 2025	Vlerësimi cilësor
Numri i Bashkive dhe gjeneruesve të mbetjeve që raportojnë të dhënat sipas sistemit	25	61	40	65.6% (+24.6% ▲ me 2019)	

Ngritja e Sistemit Kombëtar të të dhënave për menaxhimin e integruar të mbetjeve është në proces konsolidimi duke shtuar bazën e raportimit dhe rritur kapacitetet vendore përmes për grumbullimin dhe raportimin e të dhënave në nivelin e Bashkive.



**M2. Studimet e fizibilitetit janë përgatitur për të gjitha Zonat e Menaxhimit të Mbetjeve duke siguruar një program të optimizuar për financimin dhe zbatimin e Rrjetit të Integruar të Objekteve për Menaxhimin e Mbetjeve**

Studimet e Fizibilitetit për disa zona mbetjesh kanë filluar hartimin e tyre. AKM raporton se janë në proces studimet e fizibilitetit për zonat e mbetjeve Fier dhe Elbasan (me financimin e EBIF) dhe ka përfunduar hartimi për zonat e mbetjeve të Beratit, Kukës, Gjirokastrë dhe Vlorë-Jug.

Financimi i projekteve në zbatim për menaxhimin e integruar të mbetjeve nga buxheti i shtetit 2885,49 Milion Lekë për projektet të impianteve të prodhimit të energjisë nga mbetjet në Elbasan, Fier dhe Tiranë dhe 2 projekte rehabilitimi e mirëmbajtjeje (Bushat dhe Eko Park Durrës). Në proces janë edhe 2 projekte për ngritjen e sistemit të menaxhimit të integruar të mbetjeve në Vlorë dhe Berat në shumën prej 486,5 M Lekë përmes mbështetjes me financime të huaja. Të gjithë projektet e financuara nga Buxheti i Shtetit apo financimet e huaja janë projekte disa vjeçare, dhe nuk i referohen financimeve të vitit 2020.

#### Vlerësimi në përmbushjen e objektivit

Referuar vitit 2019 si vit krahasimor ku referohet se kishte asnjë studim fizibilitetit për zonat e mbetjeve, kundrejt 8 për t'u përfunduar deri në vitin 2025, vërejmë se ka progres në përmbushjen e objektivit për këtë masë.

Treguesi nr. 2-3	Viti 2019	Objektivi 2025	Realizimi 2020	Vlerësimi për 2020 krahasuar me objektivin 2025	Vlerësimi cilësor
Numri i studimeve të fizibilitetit për zonat e mbetjeve	0	8	4 (+2 në proces)	50% (+50% ▲ me 2019)	
% e projekteve të Materplanit të financuara	0	20%	3	E pamundur për vlerësim sasior	


Hartimi i Studimeve të Fizibilitetit kërkon angazhimin e burimeve njerëzore dhe financiare. Ecuria e procesit gjatë 2020 është kushtëzuar edhe nga gjendja e pandemisë COVID-19, por progresi në tre zona të mbetjeve krijon një bazë të mirë njohurish dhe përvoja për të progresuar më shpejt në hartimin e studimeve të fizibilitetit edhe në zonat e tjera të mbetjeve.

Vlerësimi lidhur me nivelin e financimit të projekteve të Masterplanit është i pamundur për shkak të mungesës së të dhënave të zbërthyer për vitin 2020, si viti i parë i zbatimit të Strategjisë. Gjatë 2020 nuk është referuar fillimi i ndonjë projekti të ri të infrastrukturës së mbetjeve me burim financimi prej buxhetit të shtetit apo ndihmës së huaj.

Më Bashki kanë zhvilluar dhe miratuar në Këshillin Bashkiak Planë Vendiore për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (PVMIM) në përputhje me Dokumentin e Politikave Strategjike Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe Planin Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të NBUEtë.

Vetëm 27 Bashki (ose 44% e totalit të Bashkive) kanë raportuar se kanë PVMIM dhe Bashkia Cërrik e ka në proces miratimi në Këshillin Bashkiak. Të dhënat e grumbulluara prej institucioneve qendrore dhe programeve të asistencës së huaj kanë plotësuar raportimin mbi numrin e Bashkive që kanë një PVMIM funksional dhe të miratuar. Vetë-vlerësimi i Bashkive lidhur me zbatimin e këtyre planeve nxjerr në pah dy anë: ndihmesën në menaxhimin e integruar të mbetjeve duke rritur efencën dhe adresuar çështjet

prioritare, por edhe pamundësinë e zbatimit të masave të renditura në to për shkak të mungesës së burimeve financiare (80% të përgjigjeve). Shkalla e realizimit të masave të planit luhet prej 20-50% duke adresuar pamundësitë financiare në rinovimin e infrastrukturës së grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve, ndërtimit të stacioneve të transferimit, nivelit të ulët të tarifës së menaxhimit të mbetjeve, etj.



<b>Bashkitë që raportojnë se kanë PVMIM</b>	Beish, Berat, Dibër, Dimal, Himarë, Fushë Arrëz, Kamëz, Kuçovë, Kurbin, Lezhë, Malësia e Madhe, Mirditë, Patos, Peqin, Përmet, Prenjas, Pukë, Pustec, Roskovec, Rogozhinë, Tiranë, Sarandë, Selenicë, Shijak, Shkodër, Skrapar, Vau i Dejës,
---	--

#### Vlerësimi në përmbushjen e objektivit

Referuar vitit 2019 si vit krahasimor ku referohet se kishte vetëm 15 bashki kishin PVMIM, kundrejt 30 për t'u përfunduar deri në vitin 2025, vërejmë se ka progres të ngadaltë në përmbushjen e objektivit për këtë masë.

Treguesi nr.4	Viti 2019	Objektivi 2025	Realizimi 2020	Vlerësimi për vitin 2020 krahasuar me objektivin 2025	Vlerësimi cilësor
Numri i bashkive që kanë një PVMIM të miratuar	15	30	27	90 % (+ 40% ▲ me 2019)	


Vetë-deklarimi i Bashkive lidhur me ndihmesën që ju jep Plan Vitor në përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe menaxhimit të mbetjeve liston një numër të madh sfidash, kryesisht financiare dhe burimesh njerëzore. Pamundësia e zbatimit të veprimeve të identifikuara, e bëjnë miratimin e PVMIM thjesht përmbushjen e një detyrimi ligjor. Pamundësia për të përmbushur afatet kohore e bën rishikimin e këtyre planeve një domosdoshmëri afatshkurtër.

**OBJEKTIVI STRATEGJIK 2: PËRMIRËSIMI I MENAXHIMIT TË MBETJEVE KA MUNDËSUAR GRUMBULLIMIN DHE TRAJTIMIN E MBETJEVE NË MËNYRË TË INTEGRUAR NË PËRPTHJE ME STANDARDET E BE**

**M4: Bashkitë mbuliminë gjithë territorin e tyre administrativ me shërbime që përmbushin standardet minimale të përcaktuara**

SKMIM përcakton standardin minimal për menaxhimin e rrymave bashkiake si vijon:


Standardi minimal për menaxhimin e rrymave bashkiake	Prioriteti
1. 100% grumbullimi i mbetjeve në zonat urbane	1
2. Mbetjet depozitohen në një vend-depozitim të kontrolluar dhe të lejuar	1
3. 90 % grumbullimi i mbetjeve në zonat rurale	2
4. Ndarja e mbetjeve për riciklim të mëtejshëm	3



Vetë-deklarimi i 37 Bashkive thekson se mbulimi në zonën urbane është 100%, ndërsa në zonat rurale ai varion nga 40% deri në 100% (mesatarja e deklaruar në nivel vendi është rreth 78% e popullsisë). Bashkia me raportimin më të ulët të popullsisë së mbuluar me shërbimin është Bashkia Memaliaj (40%), ndërsa me mbulim të plotë janë Bashkitë Tiranë, Durrës, Shijak dhe Kamëz. Zonat e referuara pa mbulimin me shërbim janë kryesisht fshatrat më të largët të territorit të Bashkive ku rrugët nuk janë të asfaltuara.


Të dhënat për mbulimin me shërbim të territorit të bashkisë janë marrë nga vetëdeklarimi i Bashkive dhe raportimet e programeve të mbështetjes së huaj si programi “Bashki të forta” dhe GIZ.

### Mbulimi i territorit të Bashkisë me shërbim



Njëzet e dy Bashki (ose 59.5% e Bashkive që janë përgjigjur pyetësorit të monitorimit) deklarojnë se ka pasur përmirësim të mbulimit me shërbim gjatë vitit 2020, krahasuar me një vit më parë, kryesisht në zgjerimin e mbulimit me shërbim ose përmirësimin e infrastrukturës së grumbullimit të mbetjeve.

### Ndryshime në cilësinë e shërbimit (mostra 37 Bashki)



Të dhënat lidhur me sasinë e mbetjeve të grumbulluara janë marrë nga Raporti i Gjendjes së Mjedisit (RGJM) 2020, ku të dhënat për vitin 2020 referojnë se janë grumbulluar rreth 841,328 ton mbetje (për 54



Bashki që kanë raportuar në AKM) ose rreth 900,000 ton mbetje në nivel vendi, krahasuar me 792, 520 ton të grumbulluar në vitin 2019.

Ndërkohë, AKUM raporton sasinë prej 695,615 ton mbetje për vitin 2020 të grumbulluar në nivelin e bashkive (ose vetëm 77% të sasisë së llogaritur në RGJM 2020). Kjo pasi jo të gjitha bashkitë që kanë raportuar tek AKM kanë raportuar edhe tek AKUM pasi bazuar në vendimin e qeverisë bashkitë që prej vitit 2019 kanë detyrimin të raportojnë pranë AKM. Raportimi tek AKUM ndodh pasi pikat fundore të trajtimit të mbetjeve si landfill sanitar apo inceneratorë kanë mbështetjen financiare të AKUM e për rrjedhojë detyrimin të raportojnë edhe pranë këtij institucioni përveç AKM-së. Është për t'u vlerësuar fakti se për vitin 2020 në dallim nga vitet e mëparshme raportimi i bashkive që kanë dërguar informacion tek të dyja këto institucione (AKM dhe AKUM) është i njëjtë.



Bashkitë nuk kanë raportuar pranë AKM mbi sasinë e gjeneruar të mbetjeve, por vetëm sasinë e grumbulluar të tyre. Vendin e pare për sasinë e grumbulluar ndër Qarqet e vendit e zë Tirana (341,850 ton mbetje), Fieri (120,053 ton mbetje); Vlora (70,112 ton mbetje) dhe Durrësi (62,576 ton mbetje). Kjo sasi më e madhe korrespondon edhe me numrin më të lartë të popullsisë në këto Qarqe. Raportimi i të dhënave nuk ndjek të njëjtin standard raportimi, që i bën të dhënat të papërpunueshme dhe rrit shkallën e gabimit në matje dhe vlerësim. AKM me mbështetjen e projektit të Agjencisë Gjermane për Zhvillim (GIZ) bëri peshimin e mbetjeve në 7 bashki të vendit: Peqin; Roskovec; Gjirokastrë; Këlcyrë; Përrenjas; Skrapar dhe Mallakastër (të cilat nuk depozitojnë mbetjet e tyre në pika përfundimtare ku ndodh peshimi).

Si rezultat i këtij ushtrimi për peshimin e mbetjeve të depozituara, në disa bashki rezultoi një diferencë e konsiderueshme midis rezultateve të peshimit në vitin 2020 dhe sasisë së deklaruar prej tyre për vitin 2019 (ku sasia e peshuar ka qenë shumë më e vogël se ajo e deklaruar). Vlen të theksohet se deklarimi në AKM i bashkive ku ndodhi vlerësimi përmes peshimit të mbetjeve, për vitin 2020, ishte i njëjtë ose pothuajse i njëjtë me rezultatet e peshimit për këtë vit, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së të dhënave të raportuara dhe të publikuara për sektorin e menaxhimit të mbetjeve. Ushtrimi i peshimit ka vazhduar gjatë vitit 2021 për të mbuluar të gjitha bashkitë që nuk depozitojnë mbetjet në pika ku ndodh peshimi, rezultatet e të cilit synojnë të përmirësojnë më tej të dhënat e deklaruar; raportuara dhe publikuara në sektorin e mbetjeve.

#### **Vlerësimi në përmbushjen e objektivit**

Referuar vitit 2019 si vit krahasimor ku referohet se mbulohej 70% e territorit të vendit me shërbimin e grumbullimit dhe të transportit të mbetjeve, kundrejt 80% për t'u arritur deri në vitin 2025, vërejmë se mungesa e të dhënave për të gjitha bashkitë dhe raportimi lidhur me popullsinë që merr shërbimin, kryesisht në zonën rurale të tyre e bën të pamundur vlerësimin sasior të progresit.

Vetë-deklarimi i Bashkive lidhur sipërfaqen e territorit të mbuluar me shërbim (si numër i popullsisë që merr shërbimin kundrejt totalit) bëhet duke u bazuar në territorin e pambuluar (si fshatra, krahasuar me të gjithë sipërfaqen e zonës). Ndonëse është e qartë që numri i popullsisë në zonën rurale, dhe kryesisht në fshatrat më të largët ka ardhur në rënie për shkak të largimit (shpopullimit), mungojnë të dhëna të sakta për popullsinë e fshatrave ku nuk ofrohet shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve. Formularët e raportimit duhet të përmbajnë numrin e popullsisë sipas të dhënave të Zyrës së Gjendjes Civile në secilën Bashki për fshatrat nuk mungon ofrimi i shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve.

Treguesit nr. 5-6	Viti 2019	Objektivi 2025	Realizimi 2020	Vlerësimi për vitin 2020 krahasuar me objektivin 2025	Vlerësimi cilësor
% e mbullimit me shërbim e shprehur si numër eqv. banorësh që marrin shërbim / nr. eqv. të banorëve rezidentë	70%	80%	81%	100%	
% sasisë së mbetjeve të grumbulluara / sasia e mbetjeve të gjeneruara (sipas planifikimit)	60%	70%	792,520 ton të grumbulluara	841,328 ton të grumbulluara (+48 808 ton ▲; 63%)	

Të dhënat e deklaruara lidhur me sasinë e mbetjeve të grumbulluara kundrejt totalit të gjeneruar, tregojnë një rritje të lehtë me 3% të sasisë së përgjithshme apo rreth 35% të objektivit sasior për 2025). Ndërkohë RGJM 2020, referon se grumbullimi, transferimi dhe trajtimi i mbetjeve vlerësohet se përfaqëson rreth 70% të gjenerimit të tyre në nivel bashkie për sa i përket mbetjeve bashkiake.

Nr.	Bashkia	2019	2020	Vlerësim 2020	Popullsia totale sipas formulës së grantit të QG	Pesha gram/ banor/dite
		Deklarimi në AKM (ton/vit)		Mesatare vjetore AKM & GIZ bazuar në rezultatet e peshimit 2020		
1	Bejsh	1,853	2,045	Peshohet në Elbasan	19,503	287
2	Cërrik	3,631	3,047	Peshohet në Elbasan	27,445	304
3	Himarë	4,194	4,107	Peshohet në Bajkaj	7,818	1,439
4	Gjirokastrë	Nuk ka raportuar	7,833	6,776	27,864	666
5	Këlcyrë	1,652	1,210	1,171	6,113	525
6	Mallakastër	9,893	1,895	1,895	27,062	192
7	Peqin	15,000	3,587	3,000	26,136	314
8	Prrenjas	3,219	3,711	2,958	24,906	325
9	Roskovec	8,566	6,736	6,736	21,742	849

10	Sarandë	12,217	9,273	Peshohet në Bajkaj	20,227	1,256
11	Skrapar	3,398	2,000	1,759	11,397	423

Bazuar në të dhënat e marra prej peshimit të mbetjeve, RGJM 2020, referon se gjenerimi i mbetjeve në Shqipëri luhetet në intervalet 200 - 450 gramë mbetje për frymë në ditë në bashkitë me natyrë rurale dhe 700 – 1,500 gramë mbetje për frymë në ditë në bashkitë me natyrë të theksuar urbane ose turistike. Kjo konfirmon edhe vlerësimet e bëra në Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2020-2035.

Gjithësesi është për t'u theksuar se rezultatet e peshimit të mbetjeve në 7 bashki të realizuara nga AKM me ndihmën e projektit të GIZ "Për modernizimin e menaxhimit dhe riciklimit të mbetjeve të ngurta miqësor me mjedisin në Shqipëri", rezultojnë se në bashki të vogla dhe me natyrë rurale mbetjet e grumbulluara për frymë janë zvogëluar ndjeshëm në krahasim me raportimet e mëparshme duke rikonfirmuar vlerësimet e bëra në SKMIM 2020-2035 dhe duke përafëruar vlerat e raportuara ndërmjet bashkive të ndryshme.

M5. Të gjitha Bashkitë e vendit kanë ndërtuar skemën e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve bazuar në efektivitetin dhe efikasitetin me të mirë. Financiare dhe standardet minimale sektoriale sipas normave të drektivave përkatëse të transpozuar në ligjin shqiptar.

Në vetë-deklarimin e të dhënave për mbetjet, MIM mbetet ende një koncept i thjeshtëzuar në grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve në impiant fundor të përpunimit të tyre. Vetëm 6 Bashki (nga 37 të përfshira në monitorim) referojnë se kanë ngritur sistemin MIM. Nga ana tjetër, 25 Bashki (apo 67.5% e Bashkive që i janë përgjigjur pyetësorit të monitorimit) referojnë se kryejnë MIM dhe pjesa tjetër deklarojnë se ky shërbim nuk ofrohet ende. Të dhënat kontradiktore lidhur me ngritjen ose funksionimin e sistemit MIM tregojnë se ka paqartësi në nivelin e Bashkive lidhur me zbatimin e standardeve të MIM.

Menaxhimi i integruar i mbetjeve nënkupton proceset që përfshijnë përdorimin e burimeve të mbetjeve në mënyrë më eficiente dhe me një ndikim sa më të vogël mbi mjedisin. Për këtë bashkitë, të cilat janë ofruesit e shërbimit të pastrimit për komunitetin si edhe gjithë operatorët e licencuar nga AKM me ndikim në mjedis duhet të kryejnë menaxhimin e mbetjeve sipas parimit të përgjegjshmërisë ndaj mjedisit.

Menaxhimi i integruar i mbetjeve ndër të tjera përfshin proceset: (i) menaxhimin e mbledhjes së rrymave të ndryshme të mbetjeve, duke zbatuar hierarkinë e mbetjeve; (ii) vënien në dispozicion të komunitetit të infrastrukturës për mbledhjen, ndarjen, riciklimin, rikuperimin dhe depozitimin e mbetjeve; (iii) sigurimin e pajisjeve me leje të posaçme dhe përmbushjen e kërkesave bazë sipas Lejes mjedisore të dhënë / lëshuar nga AKM si edhe monitorimi dhe zbatimi me rigorozitet i kushteve të lejes; (iv) dërgimin e mbetjeve vetëm tek pikat e autorizuara; (v) raportimin periodik pranë AKM sipas kuadrit ligjor dhe kushteve të lejes së dhënë; (vi) kryerjen e inspektimit mjedisor nga ana e AKM për respektimin e kushteve të lejes dhe kuadrit ligjor përkatës për bashkitë dhe qytetarët, si edhe (vii) rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimit të të gjithë aktorëve të përfshirë në menaxhimin e mbetjeve për të qenë më miqësorë ndaj mjedisit.

Mungesa e ndarjes së diferencuar të mbetjeve në burim është tipar dominues në të gjitha bashkitë e vendit. Ndarja në burim mbetet vetëm në fazë pilotimi në zona të kufizuara. Për rrjedhojë vlerësohet se realizimi i mbulimit të popullatës me shërbimin MIM është në kufirin minimal të përcaktuar nga SKMIM për vitin 2019. RGJM 2020 raporton se janë depozituar rreth 430 mijë ton (ose 51% e mbetjeve të

grumbulluara në të gjithë vendin) në impiantet rajonale të depozitimit përfundimtar të mbetjeve . Pjesa e mbetur e mbetjeve vlerësohet se hidhet në mënyrë të pakontrolluar në vend depozitime bashkiake të cilat nuk plotësojnë kushtet minimale sanitare të përcaktuar nga ligji.

Stacione fundore të trajtimit të mbetjeve (sipas zonës së mbetjeve)	Bashki që dërgojnë mbetjet në stacione fundore *)	Popullsia (sipas MB 2017)	Sasia e mbetjeve (sipas AKM 2020)	Tregues: % e popullatës në qytete me më shumë se 100,000 banorë, (zonat urbane) mbulojnë me shërbimin e MIM (sipas Bashkive 2021)
<b>Landfill Rajonal</b>				
Bajkaj	Sarandë	55,443	9,273.3	
	Himarë	27,056	4,107.0	
	Finiq	35,336	Nuk ka të dhëna	
	Delvinë	18,192	Nuk ka të dhëna	
	Konispol	13,654	690.0	
Bushat	Shkodër	205,983	34,378.0	95%
	Lezhë	110,119	17,213.0	97%
	Vau-Dejës	50,703	3,325.0	
Maliq	Korçë	135,568	19,129.0	Nuk ka të dhëna
	Maliq	62,690	7,700.0	
	Devoll	41,513	4,224.0	
Sharra	Tiranë	812,723	254,604.0	100%
	Durrës	318,862	43,545.0	100%
	Kamëz	133,737	33,990.0	100%
<b>Inceneratorë</b>				
Elbasan	Elbasan	210,789	27,595.6	Nuk ka të dhëna
	Cërrik	47,368	3,046.9	
	Belsh	33,107	2,045.0	
	Librazhd	43,518	2,409.0	

\* Shënim: Bashkia Kurbini ka filluar dërgimin e mbetjeve në landfillin e Bushatit në shtator 2020, Malësia e Madhe në dhjetor 2020, ndërsa Gramshi ka filluar të dërgojë mbetjet në inceneratorin e Elbasanit në tetor 2020.

Monitorimi i treguesit të përqindjes së popullatës për 100 mijë banorë në zonat urbane nuk mbështetet me të dhëna të raportuara nga Bashkitë apo AKM. Vetëm 18 Bashki, të cilat dërgojnë mbetjet në impiantet e trajtimit përfundimtar të mbetjeve (si landfill apo inceneratorë rajonal), kryejnë peshimin, ndërkohë vetëm 5 Bashki referojnë se mund të japin të dhëna për treguesin në fjalë.

Tabela në vijim paraqet të dhënat e grumbulluara prej disa burimeve, ku mbulimi me shërbim në zonat urbane me më shumë se 100,000 banorë nuk mbështetet me të dhëna për standardet MIM.

Të dhënat e grumbulluara nga vetë deklarimi i bashkive për treguesit e lidhur me ndarjen sipas rrymave dhe rikuperimin, janë shume të kufizuara, ku 100 % e bashkive që kanë ofruar të dhëna për monitorimin e SKMIM referojnë se nuk kanë të dhëna të tilla. Në më pak se 5% të rasteve, Bashkitë kryejnë rikuperimin për riciklimin e mbetjeve në masën 1-3%, por në kushte informale dhe të pa organizuar.

Mungojnë të dhënat nga institucionet dhe kompanitë e riciklimit mbi nivelin e rikuperimit dhe të riciklimit të rrymave të mbetjeve në përgjithësi.


Të dhënat e ofruara nga RGM 2020 dhe në deklarimin e AKM, niveli i ndarjes sipas rrymave në mbetjet mikse të bashkive prej paketimeve dhe i sasisë së mbetjeve që shkon për riciklim varion nga 0% për drurin deri në 8% për mbetjet plastike. Sipas RGM 2020, sasia totale e përlogaritur e mbetjeve nga paketimet shkon në 188, 615.7 ton për vitin 2020, prej të cilave vetëm 9,000 ton kanë shkuar për riciklim (ose 4.75% të sasisë së gjeneruar).

RGM 2020 nuk referon të dhëna për mbetjet inerte. AKUM deklaron në pyetësin për monitorimin e SKMIM për vitin 2020 se mbetjet inerte dhe dherat e grumbulluar në nivel bashkie për të gjithë territorin e vendit zënë 54% të sasisë së grumbulluar ose rreth 377,000 ton mbetje. Të dhënat nga MIE, vetëm për Operatorin që administron landfillin e Sharrës, raportojnë se janë trajtuar me standarte 248,746.58 tonë mbetje inerte dhe dhera, nga këto 210,385.19 tonë dhera dhe 38,361.39 tonë mbetje inerte.

Nga 37 Bashki të monitoruara, 6 prej tyre raportojnë se kanë venddepozitime për mbetjet inerte, por gjatë vitit 2020 nuk është ndërtuar asnjë venddepozitim i ri për këto mbetje. Rreth 30% e Bashkive (nga 37 të përfshira në monitorim) raportojnë se kanë plane ose kanë kryer procesin e aplikimit për lejen mjedisore, por nuk kanë burime financiare të mjaftueshme për t'i ngritur dhe vënë në funksionim.

Lidhur me treguesin e sasisë së depozituar në stacionet përfundimtare të trajtimit të mbetjeve, të dhënat për vitin 2020 paraqesin një sasi prej 428,469 ton mbetje ose rreth 47.6% të sasisë së grumbulluar të përlogaritur për vitin 2020. Pjesa e mbetur vijon të depozitohet në venddepozitime që nuk plotësojnë kushtet mjedisore ose mbeten të shpërndara në territor.

Sasia e ricikluar e mbetjeve në vitin 2020 kundrejt  
objektivit të SKMIM për vitin 2025



Të dhënat për sasinë e depozituar në çdo stacion përfundimtar të mbetjeve, sipas RGJM 2020, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Depozitimi përfundimtar i mbetjeve në impiante (viti 2020)

Nr.	Implanti për depozitim përfundimtar të mbetjeve	Sasia vjetore e mbetjeve të depozituara (ton)
1	Landfilli Sharrës (Tiranë)	298,150
2	Landfilli Bushatit (Vau-Dejës)	54,916
3	Landfilli Maliqit	31,029
4	Landfilli Bajkaj (Sarandë)	9,277
5	Incineratori Elbasanit	35,097
	<b>TOTAL</b>	<b>428,469</b>

Vlerësimi në përmbushjen e objektivit



Referuar vitit 2019 si vit krahasimor ku referohet se ofrohet shërbimi i MIM në masën 15%, vërehet konfuzion në nivelin e Bashkive lidhur me standardin e ofrimit të shërbimit sipas MIM. Raportimi se ky shërbim ofrohet në 25 Bashki, i referohet vetëm proceseve të grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve.



Ndonëse deklarohet progres në përmirësimin e shërbimit në 59.5% të bashkive të përfshira në këtë monitorim, nuk ka të dhëna për progresin lidhur me përmirësimin e sipas standardeve të MIM.

Si pasojë e mungesës së peshimit dhe ndarjes së mbetjeve në nivelin e Bashkive, ka mungesa të theksuara të të dhënave lidhur me sasinë e mbetjeve sipas rrymave, sasinë e rikuperuar dhe të ricikluar.

Ndonëse ka rritje të sasisë që depozitohet në stacionet përfundimtare të trajtimit të mbetjeve, ecuria e shpejtë e ndërtimit të 3 stacioneve të tilla, pritet të rrisë ndjeshëm sasinë e dërguar në to, deri në vitin 2025.

Ndërkohë, që nuk raportohet ndonjë progres lidhur me ndërtimin dhe funksionimin e stacioneve për grumbullimin e mbetjeve inerte, të ndërtimit apo të rrymave të tjera specifike.

Treguesit nr. 7-14	Viti i referencës 2019	Objektivi 2025	Realizimi 2020	Vlerësimi për vitin 2020 krahasuar me objektivin 2025	Vlerësimi cilësor
% e popullatës, mbulohen me shërbimin e MIM.	15%	30%	Mungojnë të dhënat	Nuk mund të vlerësohet	
% e popullatës në qytete me më shumë se 100,000 banorë, (zonat urbane) mbulohen me shërbimin e MIM	10%	35%	Mungojnë të dhënat	Nuk mund të vlerësohet	
% e sasisë së mbetjeve (për secilën rryme) që shkon për riciklim/sasisë totale të mbetjeve të gjeneruara në ton/vit	17%	20%	Mungojnë të dhënat	Nuk mund të vlerësohet	
% e mbetjeve të tjera të rikuperuara nga mbetjet mikse bashkiake kundrejt totalit të mbetjeve nga paketimi të rikuperueshme	5%	10%	Mungojnë të dhënat	Nuk mund të vlerësohet	
% e sasisë së mbetjeve të paketimit që rikuperohen në nivel bashkie kundrejt totalit të gjeneruar	10%	Jo më pak se 10%	4.7%	Nuk ka progres	
% e sasisë së mbetjeve që depozitohet në landfill ose venddepozitime/	50%	80%	47.6%	+45%	

sasia totale e mbetjeve të grumbulluara ton/vit					
Nr. i qendrave pritëse ose formate të tjera të ngritura nga bashkitë për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve nga prishjet dhe ndërtimet	2	10	0	Nuk ka progres	
Numri i sistemeve të depozitimit dhe trajtimit të mbetjeve të ngritura në zbatim të hierarkisë së mbetjeve	5 (landfill Bajkaj/Sarandë, Maliq/Korçë, Bushat/Shkodër, Sharrë/Tiranë, ËtE Elbasan	8 (landfill Vlorë, Berat, ËtE Fier	5 sisteme funksionale dhe 2 sisteme në proces	66%	

**M6. Në të gjithë territorin janë trajtuar dhe mbyllur sipas udhëzimeve në fuqi të gjitha vend-depozitimet bashkiake historike të mbetjeve.**


Gjatë vitit 2018, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka kryer monitorimin të të gjithë territorit, në të cilin ka identifikuar 199 vend depozitime historike. Për 44 prej tyre është dhënë statusi paraprak për rehabilitimin , me synimin që të përmirësojnë kushtet e e grumbullimit të mbetjeve të ngurta urbane dhe të zbatojnë masat për minimizimin e riskut. Nëse përmbushen këto kushte, këto venddepozitime mund të përdoren për një periudhë 3-5 vjeçare deri në ngritjen e pikave fundore të grumbullimit të mbetjeve (landfille sanitare apo incinerator) dhe bërjen funksionale të zonave të mbetjeve sipas strategjise MIM 2020-2035 përfshirë edhe ngritjen dhe operimin e stacioneve të transferimit, pajisjen me infrastrukturën grumbulluese, etj.

Të dhënat e monitorimit për vitin 2020, tregojnë se gjatë këtij viti sipas AKM janë mbyllur tre venddepozitime historike (Berat, Kuçovë dhe Dimal). Vijon puna për rehabilitimin dhe mbylljen e Porto Romanos (Durrës) dhe venddepozitimeve në Gjirokastrë, Skrapar, Këlcyrë dhe Prrerjas, të cilat pritet të përfundojnë në vitin 2021 dhe të Vlorës dhe Orikuimit, që planifikohet të përfundojnë në vitin 2022. Ndërkohë të dhënat nga 37 bashki referojnë se janë kryer punime rehabilituese, mbyllur në 18 venddepozitime historike, por një pjesë e mirë ende vijojnë operimin në pamundësi të ndërtimit të landfilleve sanitare apo të depozitimit të mbetjeve në stacionet përfundimtare të përpunimit. Në dy raste (Himarë, Cërrik) punimet rehabilituese i kanë kthyer në fusha kompostimi.

Në rastet e tjera punimet rehabilituese përmendin rrethimin, ngritjen e mureve ndarës dhe mbjelljen e pemëve. Problematika e theksuar për mbylljen e venddepozitimeve historike si edhe me rehabilitimin për përdorim të përkohshëm deri në ngritjen e vend depozitimeve përfundimtare (landfill sanitar apo incinerator) lidhet me mungesën e venddepozitime të ligjshme /stacioneve të transferimit dhe atyre të depozitimit përfundimtar për përpunimin e mbetjeve dhe mungesën e burimeve financiare për të kryer




punimet rehabilituese për mbylljen e tyre. Një pjesë e mirë e ndërhyrjeve të deritanishme janë kryer falë projekteve të mbështetura nga donatorë të huaj nëpërmjet agjencive të zhvillimit. Të dhënat e grumbulluara nga Bashkitë paraqiten në grafikun më poshtë:



Lloji i punimeve ndërhyrëse	Numri i venddepozitimeve historike	Bashkitë referuese
Punime rehabilituese të plota në venddepozitimët historike	9	Berat, Kucovë, Dimal, Patos, Durrës (në proces Porto-Romano, Gjirokastër, Skrapar, Prrrenjas, Këlcyrë)
Punime rehabilituese të pjesshme në venddepozitimët historike	5	Bulqizë, Lezhë, Këlcyrë, Gjirokastër, Peqin
Venddepozitimët mbyllura, por pa punime rehabilituese	4	Durrës, Himarë, Belsh, Poliçan,
Planifikime dhe projektme për ndërhyrje në të ardhmen	6	Mallakastër, Roskovec Krujë, Kamëz, Roskovec, Pustec

**Vlerësimi në përmbushjen e objektivit:**

Referuar objektivit të vitit 2025, vërehet se ka filluar procesi i adresimit të problemit të trashëguar për mbylljen e venddepozitimeve historike. Mungesa e financimeve dhe e gjetjes së zgjidhjeve afatgjata për stacionet përfundimtare të trajtimit të mbetjeve kufizojnë Bashkitë të hartojnë dhe zbatojnë projekte rehabilituese dhe mbylljen përfundimtare të tyre.

Treguesi nr. 15	Viti 2019	Objektivi 2025	Realizimi 2020	Vlerësimi për 2020 krahasuar me objektivin 2025	Vlerësimi cilësor
Numri i venddepozitimeve historike të trajtuara dhe/ose mbyllura kundrejt numrit total të venddepozitimeve historike, në nivel bashkie.	0	30	3 (18 vend-depozitime në nivele të ndryshme rehabilitimi/mbylljeje)	10%	



M7: Bashkive në zonat e impianteve të mbetjeve për energji dërgojnë mbetjet e tyre të paraciklueshme dhe mbetjet e pazhiera në këto impianteve.

Duke qenë se gjatë vitit 2020, vetëm Impianti WtE i Elbasanit ishte funksional, vetëm 4 bashki i dërgojnë mbetjet e tyre aty: Elbasan, Cërrik, Belsh dhe Librazhd. Në fund të vitit 2020 edhe dy bashki të tjera kanë filluar dërgimin në këtë WtE: Gramsh dhe Librazhd. Sasia e dërguar për vitin 2020 në WtE Elbasan ishte 35,777 ton, ku 77% të mbetjeve dërgohen nga Bashkia Elbasan.

#### Vlerësimi në përmbushjen e objektivit

Referuar objektivit të vitit 2025, dhe arritjeve gjatë 2020 vërehet se realizimi i dy treguesve respektivisht "numri i bashkive që dërgojnë mbetjet në WtE" dhe "sasia e mbetjeve të paraciklueshme që shkon në WtE" janë të varura prej numrit të WtE që janë në funksionim.

Ecuria e punës në WtE në Fier dhe Tiranë, pritet të rrisë numrin e bashkive që do të depozitojnë mbetjet e tyre në këto dy impiante duke filluar nga viti 2021, duke përmirësuar performacën për këto dy tregues.

Treguesi nr. 16-17	Viti 2019	Objektivi 2025	Realizimi 2020	Vlerësimi për 2020 krahasuar me objektivin 2025	Vlerësimi cilësor
Numri i bashkive që dërgojnë mbetjet e paraciklueshme dhe të pazhiera në impiantet me WtE	4	12	6	50%	
Sasia e mbetjeve që shkon për rikuperim energjie /sasia totale e mbetjeve në vit	40,000	210,000	35,777	17.5%	


**M 8. Skema kombëtare e Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit zbatohet për paketimet dhe mbetjet nga paketime**

Në informacionin e grumbulluar prej Ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore lidhur me këtë masë, referohet se gjatë vitit 2020, nuk është ndërmarrë asnjë nismë ligjore ose rregulatore për të vënë në zbatim skemën kombëtare të Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesve (PZP).

Ndërkohë të gjitha bashkitë e përfshira në monitorim, referojnë se nuk grumbullojnë mbetje nga paketimet në kuadër të kësaj skeme, duke arsyetuar në pak raste me mungesën e sistemit MIM. Gjithësesi vlen të përmendet se me mbështetjen e projektit të financuar nga Bashkëpunimi Gjerman / GIZ për menaxhimin e mbetjeve miqësor me mjedisin në 6 bashki është zbatuar skema e ndarjes së mbetjeve të riciklueshme të thata në supermarketet më të mëdha të bashkive pilote ku plastika, qelqi dhe mbetjet e kartonit mbledhen të ndara. Më tej, këto bashki i përpunojnë dhe ua shesin ricikluesve. Shifrat e para nga 6 bashkitë ku ndodh ky proces tregojnë rritje të grumbullimit të mbetjeve të riciklueshme në masën 15-20% kundrejt vitit 2019.

**Vlerësimi në përmbushjen e objektivit:**

Referuar objektivit të vitit 2025 për të grumbulluar 25% të mbetjeve nga paketimet në skemën PZP, vlerësohet se duhet adresuar me prioritet gjatë vitit 2021 e në vijim, për të arritur objektivin e vendosur për vitin 2025.

Treguesi nr. 18	Viti 2019	Objektivi 2025	Realizimi 2020	Vlerësimi për 2020 krahasuar me objektivin 2025	Vlerësimi cilësor
% e mbetjeve nga paketimet të grumbulluar nga skemat e Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit	Nuk ka	25%	Nuk ka	Nuk ka progres	

**OBJEKTIVI STRATEGJIK 3: KRIJIMI I NJË SISTEMI PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË RRYMAVE TË TJERA TË MBETJEVE JO-BASHKIAKE, I CILI BAZOHET NË HIERARKINË E MBETJEVE**

**M9. Qeveria qendrore në zbatim të parimit "përgjegjësa e zgjeruar e prodhuesit" dhe/ose në partneritet me biznesin hartojnë planet e fizibilitetit të zonave të mbetjeve, me qëllim ngritjen e sistemeve të përbashkëta dhe të veçanta të grumbullimit dhe të trajtimit të mbetjeve specifike si për gomat, bateritë, mbetjeve elektrike dhe elektronike, mbetjet organike, makinat në fund të jetës, etj.**


Lidhur me këtë masë mungojnë të dhënat e grumbulluara nga institucionet e nivelit qendror dhe vendor. Informacionet e mbledhura deklarojnë se nuk është hartuar asnjë plan fizibiliteti në zonat e mbetjeve për të ngritur sisteme të grumbullimit dhe të trajtimit të mbetjeve specifike.

Gjithashtu mungon informacioni i integruar lidhur me sasitë e baterive dhe akumulatorëve, të llumit të përdorur të trajtuar brenda impianteve të pastrimit të ujërave të përdorur, ndonëse jepen informacione se praktika të tilla të grumbullimit dhe të trajtimit zbatohen nga njësi të veçanta në nivelin vendor.

Lidhur me përdorimin e mbetjeve inerte raportohen vetëm sasitë e grumbulluara nga disa bashki apo edhe prej AKM në masën prej 377,000 ton, por nuk raportohet trajtimi dhe përdorimi i tyre.

**Vlerësimi në përmbushjen e objektivit**

Referuar objektivit të vitit 2025 për të grumbulluar 25% të mbetjeve nga paketimet në skemën PZP, vlerësohet se duhet adresuar me prioritet gjatë vitit 2021 e në vijim, për të arritur objektivin e vendosur për vitin 2025.

Treguesi nr. 19-22	Viti 2019	Objektivi 2025	Realizimi 2020	Vlerësimi për 2020 krahasuar me objektivin 2025	Vlerësimi cilësor
Numri i planeve të fizibilitetit kundrejt numrit të zonave	Nuk ka	Jo më pak se 5	0	Nuk ka progres	
% e baterive dhe akumulatorëve dërgohen në qendrat e prirjes dhe tërhiqen nga bizneset e licensuar	40%	65%	Nuk ka të dhëna	Nuk mund të vlerësohet	
% e llumrave në impiantet e trajtimit të ujërave të përdorur trajtohen pranë impianteve	5%	30%	Nuk ka të dhëna	Nuk mund të vlerësohet	
% e mbetjeve inerte që grumbullohen kalojnë në impiantet e trajtimit dhe ripërdoren	Nuk ka	30%	0	Nuk ka progress	

**M10. Ministria përgjegjëse për Mjedisin në bashkëpunim me institucionet e tjera të ngarkuara me ligj për mbetjet, harton politika kombëtare që janë të aplikueshme në nivelin e Zonës së Mbetjeve dhe bashkë për një menaxhim të qëndrueshëm të mbetjeve të rrymave specifike në zbatim të hierarkisë së mbetjeve, për mbetjet bashkiake, jo bashkiake dhe mbetjet inerte nga ndërtimi dhe prishjet.**

Gjatë vitit 2020, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka ndërmarrë disa nisma ligjore me ndikim në nivel kombëtar, të rregulluar menaxhimin e mbetjeve dhe të rrymave specifike të mbetjeve. Më konkretisht është miratuar një VKM për funksionimin e Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe 5 VKM për menaxhimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të rrezikshme, atyre inerte, etj.

VKM nr.335, datë 22.04.2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.967, datë 25.10.2013, të Këshillit të Ministrave *"Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve"*

VKM nr.418, datë 27.05.2020 *"Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2020-2035"*

VKM nr.975, datë 02.12.2020 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne Vendimin Nr. 641, datë 1.10.2014 *"Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kallmin transit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte"*

VKM nr. 846, datë 28.10.2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 452, datë 11.07.2012 *"Për lëndfilllet e mbetjeve"*

VKM nr.1032, datë 16.12.2020 "Për disa ndryshime në Vendimin nr.371, datë 11.06.2014, të Këshillit të Ministrave *"Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre"*.

VKM nr.1031, datë 16.12.2020: "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 229, datë 23.04.2014 të Këshillit të Ministrave *"Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit"*.

Për shkak të situatës së pandemisë COVID-19, dhe specifikat për menaxhimin e rrymave specifike të mbetjeve, Ministria e Mjedisit dhe Turizmit ka nxjerrë dy urdhëzues për t'i ardhur në ndihmë mirëmenaxhimit të mbetjeve për të shmangur kontaminimin nga mbetjet.


Udhëzues për masat që duhet të marrin bashkitë në lidhje me *menaxhimin e mbetjeve për të mundësuar desinfektimin e hapësirave dhe ambienteve publike.*

Udhëzues për mënyrat sesi duhet të *trajtohen mbetjet e kontaminuara me COVID në familje të cilat kanë anëtarë të sëmurë më këtë virus.*

#### Vlerësimi në përmbushjen e objektivit

Referuar objektivit të vitit 2025 për të plotësuar të gjithë kuadrin ligjor për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, ndonëse viti 2020 ka qenë një vit me problematika të veçanta prej pandemisë COVID-19, vlerësohet progres në përmbushjen e detyrimeve lidhur me plotësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator. Për

shkak të mungesës së një objektivi sasior rreth volumit të akteve që duhen përgatitur dhe miratuar për të pasur një kuadër të plotë ligjor në fushën e MIM, ecuria gjatë 2020 nuk mund të llogaritet në rrugë sasore.

Treguesi nr. 23	Viti 2019	Objektivi 2025	Realizimi 2020	Vlerësimi për 2020 krahasuar me objektivin 2025	Vlerësimi cilësor
Kuadri ligjor, rregullator dhe standardet e shërbimit dhe të menaxhimit të mbetjeve specifike janë hartuar	Nuk ka	Janë Miratuar	5 akte dhe 2 udhëzues	Ka progres	


**M11 Të gjitha bizneset që importojnë apo prodhojnë mbetje të rrymave specifike, në zbatim të parimit "të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit", ngrenë skemat e veçanta dhe/ose të përbashkëta në bashkëpunim me Bashkitë e vendit dhe përdorues të tjerë të mbetjeve specifike si për gomat, bateritë, mbetjeve elektrike dhe elektronike, mbetjet organike, makinat në fund të jetës, etj., për rikuperimin dhe trajtimin e tyre.**

Për këtë masë, të dhënat mungojnë si në deklarimin e bërë nga Bashkitë, ashtu edhe nga AKM që mbledh informacionin mbi zbatimin e kushteve të lejes mjedisore dhënë për bizneset e ndryshme që importojnë apo prodhojnë mbetje të rrymave specifike.

Nga informacioni i grumbulluar prej GIZ raportohet për ngritjen e tre skemave të kompostimit të mbetjeve organike (kryesisht mbetje bujqësore) në Bashkitë Cërrik, Sarandë dhe Himarë, të cilat do të jenë në funksionim gjatë 2021.

#### Vlerësimi në përmbushjen e objektivit

Referuar objektivit të vitit 2025 për ngritjen e 5 skemave për rrymat specifike të mbetjeve, ecuria e zbatimit për vitin 2020 mbetet e kufizuar vetëm në nismat pilote të mbështetura nga GIZ për mbetjet organike përkatësisht në Bashkitë Rrogozhinë, Cërrik, Rroskovec dhe Belsh. Prej tyre, është operacionale vetëm skema e kompostimit në Bashkinë Cërrik e cila vlerësohet se ka një kapacitet prodhues vjetor 1000 tonë pleh organik në vit. Nuk raportohen zhvillime lidhur me rrymat e tjera specifike.

Treguesi nr. 24	Viti 2019	Objektivi 2025	Realizimi 2020	Vlerësimi për 2020 krahasuar me objektivin 2025	Vlerësimi cilësor
Numri i skemave funksionale për rikuperimin dhe trajtimin e mbetjeve specifike	0	Jo më pak se 5	Fillimi i punës në katër nisma kompostimi	Nuk ka progres	

**QËLLIMI STRATEGJIK 2: PËRMIRËSIMI DHE HARMONIZIMI I KUADRIT LIGJOR TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE**

**OBJEKTIVI STRATEGJIK 4: KUADRI LIGJOR I MENAXHIMIT TË MBETJEVE ËSHTË PËRMIRËSUAR DHE HARMONIZUAR ME DIREKTIVAT EVROPIANE DHE ËSHTË NGRITUR NJË SISTEM INSTITUCIONAL EFIKAS NË NIVEL KOMBËTAR**

**M12. Autoritetet qendrore në bashkëpunim të ngushtë me pushtetin vendor kanë rishikuar legjislacionin në fuqi për menaxhimin e mbetjeve**


Ministria e Turizmit dhe Mjedisit si autoriteti përgjegjës për menaxhimin e mbetjeve ka vijuar drejtimin e politikave në këtë fushë përmes hartimit të Startegjise Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të miratuar me VKM. Ky dokument vendos qëllimet dhe objektivat strategjike të vendit për menaxhimin e integruar të mbetjeve, së bashku me masat prioritarë dhe treguesit e vlerësimit të zbatimit të tyre.

Ndër aktet ligjore të miratuara rishitas apo të rishikuara që plotësojnë legjislacionin për menaxhimin e mbetjeve, në bashkëpunim me pushtetin vendor, rendisim:

- VKM nr.335, datë 22.04.2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.967, datë 25.10.2013, të Këshillit të Ministrave "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve".
- VKM nr.418, datë 27.05.2020 "Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve,2020-2035".
- VKM nr. 846, datë 28.10.2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 452, datë 11.07.2012 "Për lëndfillet e mbetjeve".

**Vlerësimi në përmbushjen e objektivit**

Referuar objektivit të vitit 2025 për të përmbushur 100% të rishikimit të kuadrit ligjor për menaxhimin e mbetjeve, dhe specifikave të vitit 2020 për shkak të pandemisë COVID-19, ndryshimet dhe plotësimet ligjore vlerësohen se ndihmojnë në arritjen e objektivit 2025. Mungesa e një kuadri të plotë të ndryshimeve të nevojshme ligjore dhe rregullatore në fushën e MIM e bën të pamundur përcaktimin sasior të progresit gjatë 2020.

Treguesi nr. 25	Viti 2019	Objektivi 2025	Realizimi 2020	Vlerësimi për 2020 krahasuar me objektivin 2025	Vlerësimi cilësor
% e legjislacionit të rishikuar në zbatim të reformimit të parashikuar nga Dokumenti i Politikave Strategjike	5%	100%	3 akte ligjore	Ka progres	

**M13 Ligji ka parashikuar role dhe përgjegjësi institucionale të qarta për njësitë e qeverisjes qendrore dhe të qeverisjes vendore dhe institucionet e tjera, përfshirë edhe ato rajonale të cilat janë ngarkuar me funksione mbështetëse për menaxhimin e mbetjeve**


Kuadri ligjor në fuqi për menaxhimin e mbetjeve, dhe i organizimit dhe funksioneve të pushtetit vendor përcaktojnë detyrat institucionale në nivel qendror dhe vendor për menaxhimin e mbetjeve urbane dhe të rrymave specifike të mbetjeve. Rregullimet ligjore të mëtejshme mbeten të domosdoshme për:

- ✓ funksionimit efektiv të sistemit të MIM në nivelin vendor, qoftë kur ka sisteme rajonale të përpunimit përfundimtar të mbetjeve apo kur bashkitë ende nuk kanë një të tillë, përfshirë raportimin e të dhënave në nivel kombëtar.
- ✓ monitorimin e përmbushjes së standardeve kombëtare të shërbimit për qytetarin
- ✓ ngritjes dhe funksionimit të skemave të grumbullimit dhe rikuperimit të rrymave të veçanta të mbetjeve, përfshirë trajtimin e mbetjeve të rrezikshme

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me mbështetjen e GIZ ka përgatitur një dokument analize të rolit dhe përgjegjësi të të gjitha institucioneve qoftë në nivel qendror apo vendor në përputhje me kuadrin ligjor që rregullon funksionimin e tyre si edhe me direktivën e BE-së. Në vijim të kësaj analize janë hartuar 10 propozime për ndryshime ligjore të cilat synojnë qartësimin e rolit dhe përgjegjësisë së aktorëve dhe fshirjen e mbivendosjeve, konfuzionit dhe mbylljen e boshllëqeve në këtë drejtim. Dokumenti është ndarë për diskutim me disa nga atorët e interesit dhe do të jetë pjesë e diskutimeve me Këshillin e Përbashkët Pushtet Vendor – Pushtet Qendror në vijim të të cilit do të merren vendime në lidhje me propozimet e bëra.

**Vlerësimi në përmbushjen e objektivit**

Ndryshimet dhe plotësimet ligjore vlerësohen se ndihmojnë në arritjen e objektivit 2025. Mungesa e një kuadri të plotë të ndryshimeve të nevojshme ligjore dhe rregullatore në fushën e MIM e bën të pamundur përcaktimin sasior të progresit gjatë 2020.

Treguesi nr. 26	Viti 2019	Objektivi 2025	Realizimi 2020	Vlerësimi për 2020 krahasuar me objektivin 2025	Vlerësimi cilësor
% e legjislacionit të rishikuar për të ndarë qartësisht përgjegjësitë dhe rolet e institucioneve të përfshira në menaxhimin e mbetjeve	50%	100%	3 akte ligjore + dokumenti i analizës	Ka progres	

**M14 Nevoja e rivlerësimit për të siguruar një sistem të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve**

Gjatë vitit 2020, sikundërse deklarohet nga MTM apo AKM nuk është kryer vlerësim (ose rivlerësim) i sistemit të menaxhimit të integruar të mbetjeve. Në nivelin vendor, 8 Bashki (nga 37 që i janë përgjigjur pyetësorit për Monitorimin e SKMIM) kanë kryer vlerësim të planit të tyre vendor për mbetjet, megjithatë ka informacion të kufizuar shtesë mbi ndryshimet e propozuara/miratuara në këto plane vendore (tarifat dhe kostot, ndarjen e mbetjeve në burim, volumn dhe përbërjen e mbetjeve të grumbulluara).




Raportohet se këto vlerësime janë kryer në ato Bashki ku na mbështetje nga programe të asistencës së huaj për Shqipërinë.

<b>Bashkitë që raportojnë se kanë kryer rivlerësime në nivel vendor</b>	Cërrik, Dropull, Lezhë, Peqin, Përmet, Pustec, Rogozhinë
---	--

#### Vlerësimi në përmbushjen e objektivit

Referuar objektivit të vitit 2025 për të pasur në zbatim sistemin e MIM, del e nevojshme fillimi i punës për vlerësimin e këtij sistemi. Ai do të ndihmojë për vlerësimin e masave për arritjen e objektivave të SKMIM. Për më tepër, ai do të ndihmojë dhe udhëzojë Bashkitë të ngritjen e sistemit në të gjitha bashkitë dhe adresimin e sfidave me të cilat përballen menaxhimi i mbetjeve në nivel vendor.

Treguesi nr. 27	Viti 2019	Objektivi 2025	Realizimi 2020	Vlerësimi për 2020 krahasuar me objektivin 2025	Vlerësimi cilësor
Kryerja e vlerësimit për riorganizimin e sistemit të menaxhimit të integruar të mbetjeve	Rishikuar sipas MP	Në zbatim	Nuk është kryer	Nuk ka progres	


#### M15 Bashkitë miratojnë rregulloret e menaxhimit të integruar, në përputhje me udhëzimet e nxjerra

Vetëm 10 Bashki (nga 37 që janë përgjigjur për Monitorimin e Strategjisë) deklarojnë se kanë bërë ndryshime në rregulloret lokale për menaxhimin e integruar të mbetjeve, pa cilësuar llojin e ndryshimeve apo dhënë informacione të tjera shtesë mbi nevojën për to apo ndikimin në menaxhimin e mbetjeve. Prej informacioneve të deklaruara prej Bashkive, në pjesën më të madhe të rasteve referohen rishikime të pjesshme, lidhur me grumbullimin, depozitimin apo tarifat.

<b>Bashkitë që raportojnë se kanë kryer rivlerësime në nivel vendor</b>	Belsh, Himarë, Peqin, Rogozhinë, Kamëz, Prrenjas, Përmet, Sarandë, Shijak, Tiranë
---	---

#### Vlerësimi në përmbushjen e objektivit

Referuar objektivit të vitit 2025 ku të gjitha Bashkitë e vendit duhet të kenë rregullore të miratuara për MIM, vlerësojmë niveli i informacionit të dhënë është i pamjaftueshëm për të vlerësuar progresin gjatë vitit 2020.

Treguesi nr. 28	Viti 2019	Objektivi 2025	Realizimi 2020	Vlerësimi për 2020 krahasuar me objektivin 2025	Vlerësimi cilësor
Nr. i bashkive që kanë një rregullore për MIM / numri total i bashkive	5	61	3 Bashki kanë hartuar rregullore gjatë 2020	5%	

**QELIMI STRATEGJIK 3: FINANCIMI I QËNDRUESHËM I MENAXHIMIT TË MBETJEVE****OBJEKTIVI STRATEGJIK 5: BURIMET FINANCIARE PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE PARASHIKOHEN NË PLANIFIKIMIN BUXHETOR AFATMESËM TË MIRATUAR ME LIGJ****M16/1. Strukturat përgjegjëse për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve përgatisin udhëzuesin për llogaritjen e kostove dhe të tarifave për shërbimet bashklake të mbetjeve të ngurta.**


Udhëzuesi për llogaritjen e kostos për menaxhimin e mbetjeve i miratuar në 2018 përshkruan sistemin standard i llogaritjes së kostos për menaxhimin e mbetjeve për një (njësi e vetëqeverisjes vendore) NJVV të vetme. Ai bazohet në të dhënat e përgjithshme për njësinë administrative apo zonën e shërbimit; investimet kapitale (kamionët dhe kazanët e nevojshëm); kostot operative (mirëmbajtje, transport dhe personel); koston për trajtim në sistemet përfundimtare të trajtimit (tarifa e trajtimit); kostot e amortizimit (riinvestimit); kostot administrative. Miratimi i këtij udhëzuesi i mundëson Bashkitë të vlerësojnë të gjithë infrastrukturën përkatëse, burimet njerëzore dhe mjetet financiare të nevojshme për funksionimin e sistemit të menaxhimit të integruar të mbetjeve. Vënia në zbatim në nivelin vendor mundëson edhe vlerësimin e nevojës për financim në nivel kombëtar dhe për çdo ZMM.

Gjatë vitit 2020, për sektorin e menaxhimit të integruar të mbetjeve u planifikuan 4.72 Mld Lekë ose 122% më shumë se në vitin 2019 (2.21 Miliardë Lekë). Prej tyre u realizuan 3.79 Mld e barabartë me 80.3% të buxhetit të miratuar (ose 2.22 herë më shumë se realizimi në 2019).

Financime për menaxhimin e mbetjeve (fonde buxhetore alokuar dhe planifikuar nga Bashkitë) (në miliardë Lekë)	2019	2020	2021
Buxheti (në miliardë Lekë)	2.21	4.72	5.27
Realizimi (në miliardë Lekë) (% kundrejt buxhetit të miratuar)	1.71 (77.4% e buxhetit)	3.79 (80.3% e buxhetit)	1.34 *)
Trendi vjetor i plan buxhetit (në %)	100%	122%	12%

\*) realizimi për vitin 2021 është vetëm për 5 muaj e parë. Burimi informacionit Drejtoria e Thesarit, Ministria e Ekonomisë dhe Financave.

Duke vlerësuar të dhënat e SKMIM për financimet në menaxhimin e mbetjeve në periudhën 2011-2019, vërejmë se financimi i brendshëm i realizuar për këto vite ka qenë 11.76 Mld Lekë. Ndërkohë, me fillimin e zbatimit të SKMIM vetëm në dy vitet e para 2020-2021, planifikimi i Financimit të brendshëm është në masën 11.99 Mld Lekë. Peshën kryesore në financimin e brendshëm e zënë investimet në sistemet përfundimtare të përpunimit të mbetjeve dhe kryesisht për inceneratorët në Fier dhe Tiranë.



Financime për ndërtimin e infrastrukturës rajonale dhe rehabilitimin e venddepozitimeve ekzistuese	Buxheti i MJE (2020) (miliardë Lekë)
Ndërtimi i venddepozitimit Bushat (faza II)	150
Mbyllja dhe rehabilitimi i venddepozitimit ekzistues të mbetjeve të ngurta, EKO-Park Durrës	835
Impianti i prodhimit të energjisë nga mbetjet në Fier (Inceneratori i Fierit)	752.8
Impianti i prodhimit të energjisë nga mbetjet në Elbasan (Inceneratori i Elbasanit)	582.7
Impianti i prodhimit të energjisë nga mbetjet në Tiranë (Inceneratori i Tiranës)	700.0

Për shkak të pamundësisë së pushtetit vendor për të mbuluar financiarisht investime të tilla të mëdha, qeverisja qendrore i ka konsideruar strategjike dhe i ka mbuluar nga buxheti i shtetit.


Financimi i sektorit MIM nga të gjitha burimet e financimit (QQ+QV+Donatorë) gjatë vitit 2020 paraqitet si më poshtë:

Financimi i sektorit MIM	2020 Fakt (në Millardë Lekë)
Qeverisja Qendrore (Ministria e Infrastruktures dhe Energjisë)	3.02
Qeverisja Vendore (Bashkitë dhe Qarqet)	3.79
Donatorët dhe Ndihma e Huaj	0.23
<b>TOTAL</b>	<b>7.04</b>

### Vlerësimi në përmbushjen e objektivit

Referuar objektivit të vitit 2025 për të arritur në 30% të financimit nga buxheti i brendshëm kundrejt nevojës për financim në nivelin ZMM, mund të thuhet se ka pasur një progres të dukshëm. Ndonëse financimi buxhetor ka qenë për dy investime strategjike për sektorin, rritja në masën 451% (për dy vitet së bashku (2020 dhe 2021, krahasuar me 2019) është e konsiderueshme.


Faktori më i rëndësishëm për sukses në përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri është qëndrueshmëria e financimit të shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve. SKMIM dhe Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta nuk kanë një vlerësim të nevojës së sektorit për MIM, si dhe ndarjen e kostove për çdo zone mbetjesh. Për rrjedhojë, vlerësimi aktual i progresit mund të bëhet vetëm bazuar në tendencën e financimit prej buxhetit të shtetit. Kufizimi lidhur me këtë mënyrë vlerësimi lidhet me faktin se është e pamundur të krahasohet efektiviteti i financimit të dhënë për arritjen e objektivave të SKMIM.

Treguesi nr. 29	Viti 2019	Objektivi 2025	Realizimi 2020	Vlerësimi për 2020 krahasuar me objektivin 2025	Vlerësimi cilësor
% totale e financimit të Dokumentit të Politikave Strategjike nga buxheti i brendshëm (PBA) / kundrejt nevojës për financim në nivelin e ZMM për fazë (transferim dhe trajtim)	0%	30%	mbi 7 Mid Lekë realizuar	mbi 4.5 herë me shumë se 2019, por e papërcaktuar lidhur me objektivin 2025	

**M16/2 Bashkitë në bashkëpunim me pushtetin qendror përcaktojnë nevojat buxhetore për ciklin të plotë të menaxhimit të mbetjeve dhe tarifat për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve, në përputhje me parimin "ndotësi paguan" dhe parimet e "vetë-mjaftueshmërisë"**

Bashkitë i referohen mungesës së fondeve si arsye kryesore për mbledhjen e dobët të mbetjeve. Disa prej bashkive referojnë buxhete vendore shumë të ulta për vitin 2020/2021 për menaxhimin e mbetjeve kundrejt buxhetit të Bashkisë, si Bashkia Dibër (2.49%), Cërrik (4.9%), Prrrenjas (6.4%), Peqin (9%).

Rreth 40.5% e Bashkive referojnë se ka pasur rritje të buxhetit krahasuar me 2019, por jo të gjitha konstatojnë se kjo rritje ka çuar në përmirësimin e cilësisë.



**Bashkitë që raportojnë se kanë rritur pjesën e buxhetit vendor për menaxhimin e mbetjeve**

Bulqizë, Dibër\*, Dimal\*, Durrës, Finiq, Himarë\*, Gjirokastrë, Këlcyrë, Malësi e Madhe, Patos\*, Peqin, Prrenjas\*, Pukë, Tiranë, Sarandë


*\*) me përmirësim shërbimi*

Si rregull i përgjithshëm, shërbimet e grumbullimit të mbetjeve ofrohen ose nga bashkia ose nga një ndërmarrje private, e zgjedhur zakonisht me tender. Për disa nga Bashkitë e përfshira në këtë monitorim përqindja e buxhetit të alokuar nga bashkitë kundrejt nevojës për financim paraqitet në tabelën më poshtë:

Bashkia	Buxheti 2020/2021 (në 000 Lekë)	Mbullmi i nevojës për financim
Roskovec	31,628	83.3%
Belsh	9,822	61.5%
Kamëz		68%
Tepelenë		65%
Selenicë		58%
Shkodër		85%
Pukë	7,930	76.6%
<b>Mesatare në nivel vendi</b>		<b>71,1%</b>


Nga rezultatet e monitorimit të zbatimit të SKMIM vërehet se cilësia e të dhënave është e dobët, meqë mungojnë referohen jo të plota dhe ka mospërputhje. Këto problematika janë rrjedhojë e nivelit të ulët të kuptuarit dhe kryerjes së analizave financiare në lidhje me menaxhimin e mbetjeve në nivelin vendor. Bashkitë referojnë se të ardhurat e tyre nuk janë të mjaftueshme për mbulimin e kostove të shërbimit. Tarifat e menaxhimit të mbetjeve ndryshojnë ndërmjet bashkive shqiptare, nga 5,000 lekë për familje në vit në Tiranë në më pak sesa 500 lekë për familje në vit në bashki të vogla.

Tarifat e mbetjeve për shërbimet e menaxhimit të mbetjeve janë shumë të ulta dhe përcaktimi i tanishëm i nivelit të tarifave nuk synon rikuperimin e kostos. Pavarësisht tarifave të ulta, në shumë raste efienca e mbledhjes së tarifave është gjithashtu e ulët.



Si pasojë e tarifave të ulta dhe normës së ulët të mbledhjes së tarifave (deri në 60% në nivel vendi) pjesa më e madhe e kostove për shërbimet e menaxhimit të mbetjeve paguhet nga buxhetet e përgjithshme bashkiake. Meqenëse në buxhetet e bashkive nuk ka rrugëdalje për të ulur ndjeshëm shpenzimet e tjera, e vetmja mundësi e arsyeshme për financimin e shërbimeve të përmirësuara është rritja e konsiderueshme e tarifave në përputhje me parimin "Ndotësi paguan".



Gjatë vitit 2020 bashkitë e përfshira në këtë monitorim kanë deklaruar një normë grumbullimi të tarifës prej 69% (mesatare vendi) kundrejt planifikimit për grumbullimin e saj.



### Vlerësimi në përmbushjen e objektivit

Referuar objektivit të vitit 2025 për të secilin nga treguesit vërehet se ka progres në ecurinë drejt përmbushjes së objektivave. Rreth 25% e bashkive referojnë se kanë rritur buxhetet vendore për menaxhimin e mbetjeve, por 75% e tyre ende mbeten në nivelin e vitit 2019.

Treguesit nr. 30-32	Viti 2019	Objektivi 2025	Realizimi 2020	Vlerësimi për 2020 krahasuar me objektivin 2025	Vlerësimi cilësor
% e buxhetit të alokuar nga bashkitë kundrejt nevojës për financim	50%	80%	71% për Bashkitë që kanë	Ka progres të pjesshëm	


			referuar të dhëna		
% e shumës së të ardhurave nga tarifa kundrejt kostos totale të shërbimit	40%	80%	60%	Ka progres	
% e tarifës së mbledhur kundrejt planifikimit	60%	80%	69%	Ka progres	

**M17 Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Mbetjeve lehtëson marrëveshjet e financiare në nivelin e ZMM për Bashkitë dhe autoritetet menaxhuese të njësive për transferimin dhe trajtimin e mbetjeve**

Një pjesë e bashkive (19 nga 37 Bashkitë e intervistuar) që kryejnë transportin në objektet e trajtimit dhe depozitimit final të mbetjes referojnë se kjo kosto përbën një pjesë të mirë të barrës në koston e përgjithshme të menaxhimit të mbetjeve që mbulohet nga Bashkia, dhe në pak raste edhe në një pjesë të vogël nga programe të mbështjes së huaj. Në pak raste bashkitë kanë specifikuar pjesën e koston që mbulohet nga Bashkia. Kosto për transportin dhe trajtimin varion ndjeshëm në varësi të largësisë që ka Bashkia me vend depozitimit final. Kështu Bashkia Mirditë mbulon 40% të kësaj kostoje, Himara 60%; ndërsa pjesa më e madhe e Bashkive që janë përgjigjur referojnë mbulimin 100% të koston pa specifikuar mbulimin prej buxhetit të Bashkisë. Dy Bashki, Kurbini dhe Malësia e Madhe, kanë filluar transportimin drejt Bushatit vetëm në mesin e vitit 2020. Përgjithësisht referohet se nuk ka pasur rritje të koston për këtë shpenzim gjatë 2020.

Vetëm bashkitë e Qarkut Elbasan (Elbasan, Cërrik, Belsh, Librazhd) dhe prej muajit tetor 2020 edhe Bashkia Gramsh, i dërgojnë mbetjet e tyre në inceneratorin e Elbasanit, duke mbuluar koston e transportit dhe të trajtimit në incenerator. Ndërtimi i dy impjanteve të reja në Fier dhe Tiranë do të rrisë numrin e Bashkive që do të transportojnë mbetjet për trajtim në to, e për rrjedhojë do të raportohen të dhëna nga një numër më i madh bashkish lidhur me këtë tregues.

**Vlerësimi në përmbushjen e objektivit**

Treguesit nr. 33-34	Viti 2019	Objektivi 2025	Realizimi 2020	Vlerësimi për 2020 krahasuar me objektivin 2025	Vlerësimi cilësor
Bashkitë mbulojnë koston për transportin dhe trajtimin e mbetjeve në objektet e trajtimit dhe depozitimit final	50%	Jo më pak se 50% e tarifës	Referimet cilësore janë në vlerën e 2019	Nuk ka progres	
Bashkitë mbulojnë koston për transportin dhe trajtimin e mbetjeve në ËT	0%	0%	Nuk referohen të dhëna	Nuk vlerësohet	




Referuar objektivit të vitit 2025 për të mbuluar jo më pak se 50% të tarifës, kur numri i bashkive që po kryejnë transportin dhe trajtimin e mbetjeve në objektet e trajtimit final po rritet çdo vit, të dhënat janë të pamjaftueshme për të vlerësuar treguesin në nivel vendi. Për bashkitë që kanë referuar të dhëna treguesi mbetet në vlera të njëjta sikundërse viti 2019.

**M18 Agjencia Kombëtare e Ujësjetës kanalizimeve dhe Mbetjeve mbikëqyr dhe monitoron financat që lidhen me ndërtimin ose modernizimin dhe përmirësimin e infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve**

Rritja e financimit të buxhetit të shtetit në masën 122% krahasuar me 2019, për projektet e investimit në infrastrukturën për trajtimin e mbetjeve (Inceneratorët Fier dhe Tiranë, Faza e dytë e landfillit të Bushatit) si dhe në mbylljen venddepozitimit në Porto Romano, kanë ngarkuar AKUM me përgjegjësinë e mbikëqyrjes dhe të monitorimit.

**Vlerësimi në përmbushjen e objektivit**

Ecuria e realizimit të buxhetit në masën 80.3% të planifikimit për 2020, edhe në kushtet pandemisë COVID-19, tregojnë për një ecuri të kënaqshme në përmbushjen e këtij objektivit.


Treguesi nr. 35	Viti 2019	Objektivi 2025	Realizimi 2020	Vlerësimi për 2020 krahasuar me objektivin 2025	Vlerësimi cilësor
Buxheti i shtetit ka planifikuar dhe financon investimet për infrastrukturën e transportit dhe trajtimin të mbetjeve	0%	Sipas MP	80.3% e buxhetit 2020	Progress i kënaqshëm	

**M19. Ministria përgjegjëse për mjedisin propozon llojet e të ardhurave nga taksat për kategori të ndryshme produktesh të tregut shqiptar dhe i përdor këto fonde për të promovuar zvogëlimin e sasisë së mbetjeve, ripërdorimin dhe riciklimin e tyre.**

Për këtë masë gjatë vitit 2020 nuk ka pasur ndonjë nismë për të propozuar ngritjen e një Fondi për Menaxhimin e Mbetjeve me të ardhurat nga taksat e ndryshme produktesh në tregun shqiptar. Ndikimi ekonomik i Pandemisë COVID-19, ka krijuar vështirësi në ndërmarrjen e nismave të tilla që do të rrisnin barrën mbi konsumatorin dhe bizneset në vendin tonë.

**Vlerësimi në përmbushjen e objektivit**

Referuar ecurisë gjatë vitit 2020 vlerësohet se nuk ka pasur progres drejt arritjes së objektivit të vitit 2025 për ngritjen dhe menaxhimin e fondit për Menaxhimin e Mbetjeve.

Treguesi nr. 36	Viti 2019	Objektivi 2025	Realizimi 2020	Vlerësimi për 2020 krahasuar me objektivin 2025	Vlerësimi cilësor
MTM koordinon Fondin për Menaxhimin e Mbetjeve, nëpërmjet hartimit të kuadrit ligjor për përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit dhe vënien në zbatim të tij	10%	60%	Asnjë nismë	Nuk ka progres	

**OBJEKTIVI STRATEGJIK 6: MENAXHIMI I MBETJEVE ËSHTË PRIORITET KOMBËTAR DHE PJESË E RËNDËSISHME E PLANIFIKIMI TË FONDEVE TË NDIHMËS SE HUAJ, IFI DHE BE NËPËRMJET FONDEVE IPA**

**M20. Qeveria e Shqipërisë alokon jo më pak se 10% të fondeve të saj vjetore, të dhuruara për menaxhimin e mbetjeve nga institucionet ndërkombëtare dhe donatorët e tjerë.**

Programet e ndihmës së huaj për Shqipërinë në fushën e menaxhimit të mbetjeve janë ato të qeverisë Gjermane përmes GIZ dhe KfW, dhe Qeverisë së Zvicrës përmes projektit Bashki të Forta.

Me përfaqësi vlerësojmë se ndihma e huaj për menaxhimin e mbetjeve në Shqipëri për vitin 2020 ka qenë mbi 3 milionë EUR.


Kontributi financiar i projekteve të donatorëve (në EUR/Vit)	2020 (fakt)	2021 (plan)	2022 (plan)	2023 (plan)	2024 (plan)	TOTAL 2020-24
GDC - GIZ / Menaxhimi dhe Riciklimi i mbetjeve të ngurta miqësor me mjedisin në Shqipëri	1,269,672	1,650,000	1,680,328	200,000	0	4,800,000
GDC - GIZ / Mbrojtja nga ndotja e deteve (vetëm komponenti në Shqipëri)	600,000	360,000	180,000	-	0	1,140,000
GDC - KfW / Menaxhimi mbetjeve (Korce, Vlore)	NA					
SDC / SECO / Menaxhimi mbetjeve (Berat)	NA					
SDC - Helvetas / Bashki të Forta (vetëm komponenti menaxhimit të mbetjeve)	327,756	573,090	260,933	n/a	n/a	1,161,779
EUD - Menaxhimi mbetjeve (studimet e fizibilitetit për zonat e mbetjeve Elbasan dhe Fier) + planet 22-27	700,000	300,000	1,000,000	2,500,000	2,500,000	7,000,000
*Ambasada Japonese – Programi i granteve për bashkitë – vetëm mbështetje në fushën e menaxhimit të mbetjeve (makineri për grumbullimin e mbetjeve + kosha dhe kazana) për disa bashki	160,813	400,000				

<b>TOTAL financimi ne EUR</b>	<b>3,058,241</b>	<b>3,283,090</b>	<b>3,121,261</b>	<b>2,700,000</b>	<b>2,500,000</b>	<b>14,101,779</b>
-------------------------------	------------------	------------------	------------------	------------------	------------------	-------------------

Shënim: Ambasada Japoneze mbështet bashkitë e Shqipërisë përmes një programi granti "Assistance from grassroots human security projects / GGP KUSANONE". Gjatë vitit 2019 janë financuar bashkitë Mirditë dhe Tropojë, gjatë vitit 2021 janë në proces financimi bashkitë: Gjirokastër; Libohovë; Has; Roskovec dhe Sarandë.

### Vlerësimi në përmbushjen e objektivit

Krahasuar me financimin prej Buxhetit të Shtetit për 2020 prej 4.72 Mld Lekë ose 38.4 MEUR, vlerësojmë se për vitin 2020, Qeveria Shqiptare e ka tejkaluar kufirin e poshtëm të treguesit lidhur me përqindjen e burimet financiare të alokuara për menaxhimin e mbetjeve.

Treguesi nr. 37	Viti 2019	Objektivi 2025	Realizimi 2020	Vlerësimi për 2020 krahasuar me objektivin 2025	Vlerësimi cilësor
% e ndihmës së përfituar / kundrejt totalit të ndihmës së huaj	10%	35%	2.7 MEUR	Progres i kënaqshëm	


**M21. Është kryer planifikimi i detyruar dhe janë zhvilluar procedurat për hartimin dhe miratimin e projekteve në sektorin e menaxhimit të mbetjeve që kërkojnë financime publike dhe mbështetje nga donatarët**

Gjatë vitit 2020 nuk ka raportime për ndonjë proces programimi të asistencës së huaj në fushën e mbetjeve. Për programet në vijim të ndihmës së huaj, proceset e planifikimit dhe të monitorimit të përbashkët vijnë sipas strukturës organizative të projekteve dhe modaliteteve të bashkëpunimit.

### Vlerësimi në përmbushjen e objektivit

Referuar objektivit të vitit 2025 për të mbuluar 50% të investimeve në MIM prej ndihmës së huaj, vlerësohet se zbatimi i programeve në vijim, hartimi dhe zbatimi i dokumentave strategjikë për MIM, dhe rritja e kapaciteteve në institucionet qendrore dhe vendore do të krijojë parakushtet e nevojshme për rritjen e fuqisë absorbuese të vendit në hartimin dhe zbatimin e projekteve në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve. Në vitin 2021 është nënshkruar marrveshja e financimit me KfË për 50 milionë Euro kredi e butë dhe 11,9 milionë Euro Grant për financimin e infrastrukturës së mbetjeve. AKUM po kryen studimin e fizibilitetit për infrastrukturën ku do të investohen këto fonde.

Treguesi nr. 38	Viti 2019	Objektivi 2025	Realizimi 2020	Vlerësimi për 2020 krahasuar	Vlerësimi cilësor

				<b>me objektivin 2025</b>	
% e Investimeve në sektor / kundrejt parashikimit vjetor sipas Dokumentit të Politikave Strategjike dhe Master Planit	0%	50%	Nuk ka të dhëna për programe të reja	Progres në vijimin e zbatimit të programeve ekzistuese	

#### QELIMI STRATEGJIK 4: BURIMET NJERZORE, NDËRGJEGJËSIMI DHE PJESËMARRJA E POPULLATËS NË MENAXHIMIN E MBETJEVE

#### OBJEKTIVI STRATEGJIK 7: BURIMET NJERZORE DHE PJESËMARRJA

**M22. Institucionet përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve kanë përfshirë në strukturën e tyre njasitë e planifikimit dhe të menaxhimit të mbetjeve me personel të kualifikuar.**

Kualifikimi i personelit të punësuar në njasitë e menaxhimit të mbetjeve në institucionet qendrore dhe vendore vlerësohet në vijimësi si një ndër elementët kyç për rritjen e efikasitetit në ngritjen dhe funksionimin e sistemit të MIM, të monitorimit dhe raportimit të të dhënave.

Nga bashkitë e përfshira në monitorim, 13 prej tyre referojnë se kanë kryer trajnime të personelit të tyre gjatë 2020, prej të cilave kanë përfitur 24 punonjës (ose 54.5% e personelit). Këtu nuk përfshihen punonjës të kualifikuar në MIM që janë të punësuar në kompanitë kontraktore për MIM.


Stafi i përfshirë në MIM	Përfshirë në monitorim (37 Bashki)	Vlerësim i përlogaritur (61 Bashki)
<b>Pushteti vendor</b> (Bashki përgjigjur se kanë njësi dhe personel të kualifikuar)	17	61
Punonjës në sektorin e MIM	117	
<i>nga këta: të kualifikuar</i>	44	73
<i>nga këta: të trajnuar gjatë 2020</i>	24	
<b>Institucione dhe agjenci qendrore</b> MTM, MIE, MSHMS, AKM, AKUM	16	

Më shumë se gjysma e Bashkive të përfshira në monitorimin e zbatimit të SKMIM (rreth 54%) deklarojnë se nuk kanë njësi dhe staf të kualifikuar për menaxhimin e mbetjeve. Kryesisht ky grup Bashkish e ofron shërbimin përmes kompanive të kontraktuara. Ndonëse mungesa e personelit të kualifikuar kushtëzohet

prej burimeve të kufizuara financiare, pranohet se sjell si pasojë probleme lidhur me monitorimin e cilësisë së shërbimit dhe raportimit të të dhënave.

### Vlerësimi në përmbushjen e objektivit

Referuar objektivit të vitit 2025 për të pasur 200 punonjës të kualifikuar në MIM, vërehet se ka një progres të vogël drejt rritjes së personelit të kualifikuar. Vijimi i kualifikimit përmes trajnimeve edhe gjatë vitit 2020, pavarësisht kufizimeve të këtij viti, është mundësi për arritjen e objektivit brenda vitit 2025.

Treguesi nr. 39	Viti 2019	Objektivi 2025	Realizimi 2020	Vlerësimi për 2020 krahasuar me objektivin 2025	Vlerësimi cilësor
Numri i personelit administrativ të punësuar me kohë të plotë për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në të gjithë vendin	80	200	~90	Ka progres në 45% të objektivit (+13% rritje e numrit krahasuar me 2019)	

**M23. Krijohet sistemi i kurrikulës së kualifikimit. Paketa e trajnimit të vazhduar e ofruar prej OKEV dhe ASPA, së bashku me personelin teknik përkatës do të vlerësohen me kredite vjetore për aftësitë e fituara**

Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve është tematikë e kurrikulës së kualifikimit në ASPA dhe ofrohet për punonjësit e administratës qendrore dhe vendore. Kurse trajnimi me tematika specifike si përlogaritja e kostos dhe tarifës referohen të jenë pjesë e kalendarit të trajnimeve në vitet e shkuara.

Gjatë vitit 2020, nuk referohen të dhëna për trajnime specifike në MIM apo për mbetjet e rrezikshme, edhe për shkak të kufizimeve prej pandemisë COVID-19.

Një peshë në trajnimin e stafëve të administratës vendore është mbuluar nga programet e asistencës së huaj për Shqipërinë si GIZ dhe Bashki të Forta. Nga bashkitë e përfshira në monitorim, 13 prej tyre referojnë se kanë kryer trajnime të personelit të tyre gjatë 2020, prej të cilave kanë përfitur 24 punonjës (ose 54.5% e personelit). Këtu nuk përfshihen punonjës të kualifikuar në MIM që janë të punësuar në kompanitë kontraktore për MIM.



Bashkitë që raportojnë se stafet e tyre janë trajnuar në tematika të MIM

Dibër, Himarë, Kamëz, Këlcyrë, Krujë, Lezhë, Mirditë, Patos, Përmet, Prrerjas, Pustec, Pukë, Sarandë, Shijak, Shkodër, Tepelenë, Tiranë

### Vlerësimi në përmbushjen e objektivit

Referuar objektivit të vitit 2025 për të kualifikuar të gjithë stafin e përfshirë në menaxhimin e integruar të mbetjeve, sidomos në tematika specifike si ajo e menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme, duhen planifikuar

kualifikime në kuadër të ASPA si dhe grumbulluar informacion mbi kualifikimet prej kompanive të ndryshme në këtë fushë.

Treguesit nr. 40-42.1	Viti 2019	Objektivi 2025	Realizimi 2020	Vlerësimi për 2020 krahasuar me objektivin 2025	Vlerësimi cilësor
% e personelit të specializuar që trajnohet në vit	50%	100%	54.5%	Ka pak progres	
Nr. Trajtimeve në vit për institucionet publike apo private që gjenerojnë mbetje të rrezikshme	0	4	0	Nuk ka progres	
Nr. trajtimeve periodike për kompanitë që trajtojnë mbetjet të rrezikshme	0	4	Nuk ka të dhëna	Nuk vlerësohet	

#### M24. Në universitete zhvillohet ekspertizë për "green procurement"

Katër universitete të sistemit publik dhe privat që janë përfshirë të ofrimin e të dhënave për monitorimin e SKMIM për vitin 2020, referojnë se kanë degë me tematikën e Menaxhimi Mjedisor. Kurrikula universitare përmban njohuri dhe aftësim praktik përmes vizitave dhe vëzhgimi në mjediset e objekteve përfundimtare të trajtimit të mbetjeve. Programet studimore ku trajtohen më thellësisht parimet dhe teknologjitë më të mira të mundshme në fushën e MIM janë programet Master Shkencor. Ndërkohë që rritja e mundësive në tregun e punës për menaxhim mjedisor ka shtyrë institucionet akademike të propozojnë dhe hapin programe të reja në këtë fushë (Universiteti Polis me Programin Bch) që kanë rritur mundësinë e zgjedhjes për studentët në fushën e menaxhimit mjedisor.

Universiteti	Program studimi Bachelor			Numri i studentëve (diplomuar 2020)	
	Bachelor(Bch)	Master Shkencor	Master Profesional	Bch	Msc
U. Tiranës		√			15
U. Politeknik i Tiranës		√	√	44	25
U. Bujqësor i Tiranës	√	√		97	23
U. Polis	√	√		-	25
<b>Total</b>	<b>2</b>	<b>4</b>	<b>1</b>	<b>141</b>	<b>88</b>


Institucionet akademike referojnë organizimin e konferencave shkencore dhe ndërmarrjen e punimeve shkencore, kryesisht të nivelit Punim diplome në programin Master Shkencor, për menaxhimin e integruar

të mbetjeve. Gjatë vitit 2020, në këto universitete janë diplomuar 6 studentë të cilët kanë mbrojtur tema në fushën e MIM.

Megjithatë, duhet vlerësuar më në hollësi trajtimi i tematikës së Prokurimit të Gjelbërt në menaxhimin e integruar të mbetjeve, si tregues i monitorimit të kësaj strategjie.

#### Vlerësimi në përmbushjen e objektivit

Referuar objektivit të vitit 2025 për të pasur 20% të studentëve të diplomuar në planifikimin urban, kërkohet një studim më i thelluar krahasimor, por edhe i fokusuar në çështjet të menaxhimit të integruar të mbetjeve. Duke vlerësuar objektivin prej 200 punonjës të kualifikuar në MIM deri në vitin 2025, me numrin e studentëve të diplomuar në vitin 2020 (221 studentë në të gjithë programet), vlerësojnë se ecuria drejt përmbushjes së objektivit është e mirë.

Treguesi 42.2	Viti 2019	Objektivi 2025	Realizimi 2020	Vlerësimi për 2020 krahasuar me objektivin 2025	Vlerësimi cilësor
% (numri i të trajnuarve në planifikim urban/numrit të diplomuarve në inxhinieri)	0%	20%	221 studentë të diplomuar në 2020	Progres i kënaqshëm	

#### OBJEKTIVI STRATEGJIK 8: QYTETARËT PËRDORIN DHE RESPEKTOJNË INFRASTRUKTURËN E MBETJEVE DHE BËHEN PJESË E MASAVE PËR PËRMBUSHJEN E OBJEKTIVAVE TË PLANEVE VENDORE

##### M25. Qytetarët janë të përfshirë dhe konsultohen për hartimin e Planeve të Menaxhimit të Mbetjeve


Nga 8 Bashkitë që referojnë hartimin dhe Miratimin e PVMIM gjatë vitit 2020, pesë prej tyre (ose 62%) referojnë se kanë organizuar proceset e pjesëmarrjes publike për diskutimin paraprak të planit vendor. Në pak raste jepet informacion më i detajuar rreth tipologjisë së aktiviteteve pjesëmarrëse si konsultime me banorët, kryepleqtë dhe nxënësit.

Në tre raste referohet ndihmesa e dhënë për proceset e konsultimit publik prej organizatave jofitimprurëse ose kompanitë e kontraktuara për hartimin e planit vendor të menaxhimit të mbetjeve.

Bashkitë që raportojnë se procese pjesëmarrëse gjatë hartimit të PVMIM gjatë 2020	Belsh, Malësia e Madhe, Mirditë*), Patos*), Përmet, Prrenjas, Pustec*) Roskovec
---	--


#### Vlerësimi në përmbushjen e objektivit:

Referuar objektivit të vitit 2025 për të pasur pjesëmarrje publike të plotë, mund të themi se është krijuar kuptimi i drejtë i nevojës për organizimin e proceseve pjesëmarrëse në hartimin e planeve vendore.

Treguesi nr. 43-44	Viti 2019	Objektivi 2025	Realizimi 2020	Vlerësimi për 2020 krahasuar me objektivin 2025	Vlerësimi cilësor
% (numri) i planeve të hartuara me pjesëmarrje komunitare /totalit të planeve të miratuara	70%	100%	5 plane me procese pjesëmarrëse (nga 8 të miratuar)	62%	
% (numri) i banorëve që ndajnë mbetjet në burim/kundrejt popullsisë së mbuluar me shërbim të diferencuar	0%	30%	Nuk ka të dhëna	Nuk vlerësohet	

**M26. Bashkitë organizojnë fushata të përvitshme të ndërgjegjësimit "Let's do it" që nxisin sjellje të përgjegjshme mjedisore për reduktimin, ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve**

Ndërgjegjësimi qytetar për menaxhimin e mbetjeve vlerësohet i domosdoshëm për të rritur efikasitetin e operimit të sistemit dhe për të përmirësuar cilësinë e shërbimit. Ndonëse një vit me kufizime në lëvizjen e qytetarëve prej pandemisë COVID për rreth 3 muaj, 70% e Bashkive të intervistuar për këtë monitorim (26 nga 37 Bashki në total) referojnë se kanë organizuar 2-3 aktivitete gjatë vitit 2020. Të tilla kanë qenë aktivitete me nxënës shkollash, qytetarë dhe biznese. Për të rritur forcën e mesazheve ndërgjegjësuese, aktivitetet janë organizuar në ditë mjedisore si për shembull 22 Prill: Dita e Tokës, 5 Qershor: Dita e Mjedisit, gjatë sezonit turistik, etj.

Treguesi nr. 45	Viti 2019	Objektivi 2025	Realizimi 2020	Vlerësimi për 2020 krahasuar me objektivin 2025	Vlerësimi cilësor
Nr. i bashkive që organizojnë veprimtari ndërgjegjësimi dhe pastrimi / kundrejt totalit të bashkive	40%	100%	Mbi 50 aktivitete në bashkitë e intervistuar	70%	

**M27. Kurse dhe materiale edukuese duhet të shpërndahen nëpër shkolla në të gjithë vendin duke organizuar orë mësimore dhe aktivitete edukuese për nxënës**

Në raportimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve jepet informacion se Edukimi Mjedisor është kurrikulë më zgjedhje. Shkollat udhëzohen në çdo fillim viti shkollor të organizojnë aktivitete dhe projekte



mjedisore në kuadër të trajtimit ndër-lëndor. Por mungojnë të dhëna sasiore se sa shkolla kanë qenë përfshira në aktivitete për ndarjen e mbetjeve në burim apo të zhvillimit të Edukimit Mjedisor sipas niveleve të ndryshme arsimore.

Kontribut të rëndësishëm vijnë të japin Organizatat Jo Fitimprurëse (OJF) në nivel vendor të cilat organizojnë aktivitete ndërgjegjësuese dhe nxisin sjellje të përgjegjshme mjedisore përfshirë reduktimin, ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve.

**Vlerësimi në përmbushjen e objektivit:**

Referuar objektivit të vitit 2025 për të pasur një kurikulë të Edukimit Mjedisor në shkolla dhe që shkollat të përfshihen në aktivitete konkrete për ndarjen e mbetjeve në burim, kërkohet një kordinim më i mirë në nivel vendor mes institucioneve arsimore (Zyrat e Arsimit dhe shkollat) dhe Bashkive. Ndonëse ka informacione sporadike rreth aktiviteteve që organizohen në shkolla, të dhënat nuk raportohen as nga Institucionet përgjegjëse për Arsimin dhe as nga Bashkitë.

Treguesit nr. 46-47	Viti 2019	Objektivi 2025	Realizimi 2020	Vlerësimi për 2020 krahasuar me objektivin 2025	Vlerësimi cilësor
% (numri i shkollave që e kanë/aplikojnë në kurrikul edukimin për mbetjet	80%	100%	Nuk ka të dhëna	Nuk vlerësohet	
% (numri i shkollave që e kanë/aplikojnë ndarjen e mbetjeve në burim	5%	50%	Nuk ka të dhëna	Nuk vlerësohet	

**QELIMI STRATEGJIK 5: JANË NGRITUR INSTRUMENTAT LIGJORË, INSTITUCIONALË DHE FINANCIARË PËR TË PËRMIRËSUAR MENAXHIMIN E MBETJEVE TË RREZIKSHME**

**OBJEKTIVI STRATEGJIK 9: JANË IDENTIFIKUAR TË GJITHA RRYMAT E MBETJEVE TË RREZIKSHME QË JANË PRODHUAR APO PRODHohen NË TERRITORIN E VENDIT NGA SEKTORI PUBLIK DHE AI PRIVAT**

**M28. Hartimi i një sistemi të dhënash për mbetjet e rrezikshme (inventarizimi i mbetjeve të trashëguara nga industritë ekzistuese, nga industritë që gjenerojnë sot mbetje të rrezikshme)**


AKM ka regjistruar kompanive të cilat prodhojnë, transportojnë apo përpunojnë mbetje të rrezikshme, në të cilin çdo Kompani ka numrin e saj unik. Por nuk referohet hartimi i regjistrit inventarizues të mbetjeve të rrezikshme, të trashëguara apo që gjenerohen sot nga prodhimi industrial.

Sipas AKM, kompanitë në vendin tonë kanë kapacitete të vogla prodhimi, transporti apo përpunimi të mbetjeve të rrezikshme të cilat janë më poshtë sesa kufiri i përcaktuar për të raportuar sipas Rregjistrit të Shkarkimit dhe të Transferimit të Ndotësve (RrShTN).

Gjatë vitit 2020 ka nisur planifikimi i aktiviteteve për përmirësimin e raportimit të kompanive në RrShTN, në kuadër të një projekti rajonal për PRTR, i cili pritet të përmirësojë cilësinë e raportimit dhe rrisë numrin e kompanive që raportojnë.

**Vlerësimi në përmbushjen e objektivit**

Referuar objektivit të vitit 2025 për të pasur të gjithë kompanitë që raportojnë sipas formularit RrShTN, mund të thuhet se gjatë 2020, nuk ka pasur progres për këtë masë.

Treguesi nr. 48	Viti 2019	Objektivi 2025	Realizimi 2020	Vlerësimi për 2020 krahasuar me objektivin 2025	Vlerësimi cilësor
% e Institucioneve/bizneseve që gjenerojnë mbetje të rrezikshme që informojnë sipas kategorive dhe formatit të mbetjeve, të identifikuar	30%	100%	Nuk ka ndryshim	Nuk ka progres	

**M29. Hartimi i Master Planit për rryma të veçanta mbetjesh përfshirë mbetjet e rrezikshme**

Gjatë 2020, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit si ministria përgjegjëse për hartimin e Master Planit përfshirë rryma të veçanta mbetjesh dhe mbetjet e rrezikshme nuk ka referuar ndonjë nismë për fillimin e hartimit të këtij dokumenti strategjik.

**Vlerësimi në përmbushjen e objektivit**

Referuar objektivit të vitit 2025 për të cilin nuk parashikohet Hartimi i Master Planit deri më 2025, mund të themi se nuk ka progres.

Treguesi nr. 49	Viti 2019	Objektivi 2025	Realizimi 2020	Vlerësimi për 2020 krahasuar me objektivin 2025	Vlerësimi cilësor
Plani kombëtar për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme është hartuar	-	-	Nuk ka zhvillime	Nuk ka ndryshim	

**M30. Janë hartuar dhe zbatohen udhëzimet, protokollet, standardet dhe programet e trajnimit për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme**

Gjatë vitit 2020, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka hartuar 2 akte nën-ligjore dhe 2 Udhëzime, të cilat përmbajnë rregullat lidhur me transportin dhe lëvizjen e mbetjeve të rrezikshme, si dhe përpunimin e trajtimin e mbetjeve të kujdesit shëndetësor dhe sanitar në kujdesin e të sëmurëve me COVID-19.

VKM nr.975, datë 02.12.2020 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne Vendimin Nr. 641, datë 1.10.2014 "Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve Inerte"

VKM nr.1032, datë 16.12.2020 "Për disa ndryshime në Vendimin nr.371, datë 11.06.2014, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre".

Udhëzues për masat që duhet të marrin bashkitë në lidhje me **menaxhimin e mbetjeve për të mundësuar desinfektimin e hapësirave dhe ambienteve publike.**

Udhëzues për mënyrat sesi duhet të **trajtohen mbetjet e kontaminuara me COVID në familje të cilat kanë anëtarë të sëmurë më këtë virus**

Këto akte shërbejnë si bazë trajnimi dhe kualifikimi për personelin që merret me menaxhimin e tyre.

Në RGJM 2020 nuk referohen të dhëna për sasi të mbetjeve të gjeneruara, sipas rrymave të veçanta. Mungesa e të dhënave vërehet edhe në informacionet e dërguara nga Bashkitë e përfshira në procesin e monitorimit të SKMIM.

Në nivel vendit, të dhënat për rrymat e mbetjeve mungojnë, për shumicën e rrymave. Bashkitë referojnë se nuk kanë të dhëna duke listuar më së shumti mungesën e sistemit të menaxhimit të integruar të mbetjeve). Në disa raste të dhënat janë pjesore, për ndonjë rrymë të veçantë, pa mundur të llogaritet sasia në nivel vendit për shembull Bashkia Dropull referon grumbullimin e 5 ton mbetje elektrike dhe elektronike, ndërkohë që Bashkia Këlcyrë referon sasinë prej 1 ton për këtë rrymë mbetjesh.


Për mbetjet nga llumi i impianteve të grumbulluara dhe të trajtuara të dhënat nga MIE referojnë sasinë prej 54 ton, që paraqet një sasi 87% më të ulët sesa një vit më parë.

Të dhënat lidhur me mbetjet spitalore konfirmojnë së këto mbetje ndahen në burim si mbetje të rrezikshme prej pjesës tjetër të mbetjeve jo të rrezikshme. Sipas raportimit nga 42 spitalet publike, QKTGj dhe QKTRF, sasia e mbetjeve spitalore të rrezikshme të grumbulluara gjatë vitit 2020 është rritur me +33.8%, ndërsa mbetjet e grumbulluara nga 15 spitalet jo-publike janë zvogëluar me -12.8%. Në total, sasia e grumbulluar e mbetjeve të rrezikshme spitalore është rritur me +16.9%, ndërsa ajo e trajtuar është rritur me +13.7% ky ndikim të veçantë ka pasur shtimi i masave mbrojtëse në trajtimin e pacientëve gjatë pandemisë COVID-19.

Të dhënat në tabelën e mëposhtme paraqesin sasi të grumbulluara dhe të trajtuara të mbetjeve të rrezikshme spitalore gjatë vitit 2020, krahasuar me vitin e referencës 2019.

Mbetjet spitalore (kg)	2019			2020		
	Grumbulluar	Trajtuar	% e trajtuar ndaj sasisë së grumbulluar	Grumbulluar	Trajtuar	% e trajtuar ndaj sasisë së grumbulluar
Institucione shëndetësore publike	442,119	440,119	99.5%	591,469	567,313	95.9%







Spitale private	252,461	252,461	100.0%	220,157	220,157	100.0%
<b>Total (kg)</b>	<b>694,580</b>	<b>692,580</b>	<b>99.7%</b>	<b>811,626</b>	<b>787,470</b>	<b>97.0%</b>



#### Vlerësimi në përmbushjen e objektivit

Referuar objektivit të vitit 2025 për rrymat e ndryshme të mbetjeve, përfshirë edhe ato të rrezikshme, mungesa e të dhënave të disponueshme në institucionet qendrore apo ato vendore, e bën të pamundur vlerësimin e progresit drejt përmbushjes së objektivit të kësaj mase. Edhe vlerësimi cilësor i bazuar në informacionet pjesore të grumbulluara tregon për mungesën e progresit në tërësi.

Treguesit nr. 50-59	Viti 2019	Objektivi 2025	Realizimi 2020	Vlerësimi për 2020 krahasuar me objektivin 2025	Vlerësimi cilësor
% e mbetjeve minerare të grumbulluara dhe të trajtuara kundrejt totalit të kësaj kategorie të gjeneruar	0%	20%	Nuk ka të dhëna	Nuk ka progres	☹️
% e mbetjeve kimikate të grumbulluara dhe të trajtuara kundrejt totalit të kësaj kategorie të gjeneruar	Nuk ka	30%	Nuk ka të dhëna	Nuk ka progres	☹️
% e mbetjeve bujqësore dhe drurit të grumbulluara dhe të trajtuara kundrejt totalit të kësaj kategorie të gjeneruar	Nuk ka	40%	Nuk ka të dhëna	Nuk ka progres	☹️
% e mbetjeve nga gomat të grumbulluara dhe të trajtuara kundrejt totalit të kësaj kategorie të gjeneruar	Nuk ka	25%	Nuk ka të dhëna	Nuk ka progres	☹️

% e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike të grumbulluara dhe të trajtuara kundrejt totalit të kësaj kategorie të gjeneruar	5%	35%	Të dhëna të pjesshme	Nuk ka progres	
% e mbetjeve nga llumi i implanteve të grumbulluara dhe të trajtuara kundrejt totalit të kësaj kategorie të gjeneruar	Nuk ka	30%	54 ton	-46.8 ton (-87%) më pak se 2019	
% e mbetjeve nga produktet e kafshëve të grumbulluara dhe të trajtuara kundrejt totalit të kësaj kategorie të gjeneruar	Nuk ka	10%	Nuk ka të dhëna	Nuk ka progres	
% e mbetjeve vajra të grumbulluara dhe të trajtuara kundrejt totalit të kësaj kategorie të gjeneruar	10%	30%	Nuk ka të dhëna	Nuk ka progres	
% e mbetjeve nga bateritë dhe akumulatorët të grumbulluara dhe të trajtuara kundrejt totalit të kësaj kategorie të gjeneruar	40%	65%	Nuk ka të dhëna	Nuk ka progres	
% e mbetjeve spitalore të grumbulluara dhe të trajtuara kundrejt totalit të kësaj kategorie të gjeneruar	50%	65%	Të dhëna vetëm nga sistemi terciar	+33.8 krahasuar me 2019	

**M31. Prodhuesit e mbetjeve të rrezikshme sigurojnë se menaxhimi i mbetjeve të rrezikshme bëhet në përputhje me kërkesat ligjore dhe udhëzimet në fuqi dhe zbatojnë ndarjen e mbetjeve të rrezikshme nga ato të parrezikshme**

Për vitin 2020, nuk ka informacion lidhur me zbatimin e kësaj mase, ndonëse AKM referon se prodhuesit shqiptarë prodhojnë sasi më të vogla sesa referohen në kërkesën për raportim sipas RrShTN.



Ndarja e mbetjeve të rrezikshme përcaktohet si kusht në lejen mjedisore të prodhuesve. Prodhuesit duhet të raportojnë pranë AKM lidhur me sasinë e prodhuara çdo vit dhe për zbatimin e kushtit të ndarjes së këtyre mbetjeve.

Nga raportimi për monitorimin e SKMIM, të dhënat lidhur me mbetjet spitalore konfirmojnë se këto mbetje ndahen në burim si mbetje të rrezikshme prej pjesës tjetër të mbetjeve jo të rrezikshme. Për lloje të tjera mbetjesh të rrezikshme nuk ka informacion.

#### Vlerësimi në përmbushjen e objektivit

Referuar objektivit të vitit 2025 për të pasur raportim prej të gjithë prodhuesve dhe zbatimin e detyrimit të tyre për të ndarë mbetjet e rrezikshme që në burim, kërkohet të bëhet funksional sistemi i raportimit prej të gjithë kompanive pranë AKM, e cila përveç rregjistrimit të kompanive që prodhojnë, transportojnë apo përpunojnë mbetje të rrezikshme mban edhe rregjistrin e inventarit të këtyre lloj mbetjesh.

Treguesit nr. 60-61	Viti 2019	Objektivi 2025	Realizimi 2020	Vlerësimi për 2020 krahasuar	Vlerësimi cilësor
------------------------	--------------	-------------------	-------------------	---------------------------------	----------------------

				me objektivin 2025	
Nr. I kompanive që gjenerojnë dhe trajtojnë mbetje të rrezikshme që raportojnë rregullisht në RrSHTN kundrejt totalit të tyre në vend	20%	100%	Nuk ka të dhëna	Nuk ka progres	
% e mbetjeve të rrezikshme që ndahen nga mbetjet e parrezikshme	1%	3%	Nuk ka të dhëna	Nuk ka progres	

## 7. PËRFUNDIME

1. Viti 2020 ishte viti i parë i zbatimit të SKMIM vërehet se ka pasur ecuri në zbatimin e masave të planifikuara (sipas planifikimi apo edhe më të mirë) për 40% të treguesve (nga ku në 15% të rasteve ecuria ka qenë më e mirë së parashikimi për vitin e parë).

Ecuria më e mirë vërehet në zbatimin e treguesve që lidhen me plotësimet ligjore, hartimin e planeve vendore dhe financimin e investimeve strategjike që lidhen me përpunimin fundor të mbetjeve të grumbulluara.

2. Viti 2020 ishte një vit i vështirë, si rezultat i kufizimeve të imponuara nga qeveria shqiptare në kuadrin e luftës kundër pandemisë së COVID-19, i cili solli edhe një sërë vështirësish në zbatimin e masave që lidhen me ngritjen e sistemit të menaxhimit të integruar të mbetjeve në nivel vendor. Mungesa e sistemit por edhe kufizimet prej pandemisë sollën mangësi në menaxhimin e mbetjeve në nivelin vendor lidhur me mbulimin e kostove të shërbimit, përmirësimin e infrastrukturës vendore, rritjen e burimeve njerëzore në nivelin e bashive apo edhe të menaxhimit të rrymave specifike. Për 42% të treguesve të performancës vërehet se nuk ka pasur ecuri ose ajo ka qenë në nivele të pakënaqshme lidhur me planifikimin kundrejt arritjes së objektivit të vitit 2025.

3. Ecuria e zbatimit të SKMIM për vitin e parë të zbatimit është e pamundur të vlerësohet për shkak të mungesës së të dhënave si rezultat i mos ndarjes së mbetjeve sipas rrymave, i mos peshimit të mbetjeve të grumbulluara apo i mungesës së të regjistruara të raportimit. Për më tej, mungesa e grumbullimit të të dhënave të tjera që lidhen me kualifikimin, edukimin, aktivitetet pjesëmarrëse dhe ndërgjegjësuese, e bëjnë të vështirë vlerësimin e shkallës së efektivitetit të tyre në ndikimin që masa të tilla kontribuojnë në përmirësimin e gjendjes së menaxhimit të mbetjeve apo rritjes së efektivitetit të mbështetjes në infrastukturën e mbetjeve. Ecuria në vitin e parë të zbatimit ka qenë e pamundur të kryhet për 18% të treguesve të performancës.

4. Vlerësimi i ecurisë bëhet i mundur vetëm përmes të dhënave sa më të plota dhe të besueshme. Siç konstatohet në këtë Raport Vlerësimi ka pasur vështirësi për marrjen e të dhënave kryesisht nga institucionet e qeverisjes vendore. Të dhënat e referuara nga niveli vendor dhe institucionet në nivelin qendror shpesh referojnë të dhëna që nuk përputhen, madje me kufinj gabimi të konsiderueshëm. Për përmirësimin e cilësisë së të dhënave duhet unifikuar raportimi sipas një formati të standartizuar dhe të përfshihen edhe Prefekturat.

5. Më tej, shtrirja e peshimit të mbetjeve në të gjitha njësitë vendore, në të dy sezonet e lagësht dhe të thatë, do të ndihmojë në përmirësimin e cilësisë së raportimit të sasisë së grumbulluar të mbetjeve dhe ndarjes së tyre sipas rrymave.

6. Vërehet tendenca e rritjes së financimeve për menaxhimin e mbetjeve në nivel vendor, por në shumicën e rasteve kjo rritje nuk është shoqëruar me rritjen e cilësisë së shërbimit apo të mbulimit me shërbim në të gjithë territorin e bashkisë. Në një vlerësim të përgjithshëm, kjo situatë mund të çojë drejt përfundimit se efica nca në përdorim e fondeve në nivelin vendor është ulur.

7. Financimet në nivelin qendror kryesisht kanë mbuluar nevojën e investimeve strategjive për impijantet fundore të trajtimit të mbetjeve. Duke vlerësuar novojat për të gjithë hallkat e zinxhirit të MIM, vlerësojmë se financimi i orientuar drejt investimeve strategjike ka lënë boshllëqe në zbatimin e masave të tjera të SKMIM apo edhe të hallkave të veçanta të MIM. Kështu, prioritet i duhet dhënë maave reabilituese dhe mbylljes së vendgrumbullimeve historike të mbetjeve që bëhen shkak për ndotjen e ujrave të lumenjve, tokës dhe të mjedisit në përgjithësi.

8. Në nivelin e NjQV, të vijojë mbështetja me kualifikimin e nevojshëm për personelit të ngarkuar me MIM për një kuptim të saktë dhe të plotë të kërkesave dhe standarteve për këtë lloj menaxhimi. Të dhënat e grumbulluara në kuadër të këtij raporti konfirmojnë nevojën e kualifikimit të vazhduar përmes përfshirjes në programet specifike të institucioneve përgjegjëse si ASPA dhe institucionet akademike (universitetet) të moduleve të veçantë, në një program gjithë vjetor.

9. Të vlerësohet nevoja e përfshirjes në skemën e raportimit edhe të institucioneve të tjera qendrore me ndikim në gjenerimin e mbetjeve në rryma të caktuara, të cilat grumbullojnë këto mbetje. Gjatë vlerësimit të vitit 2020, u identifikua Ministria e Mbrojtjes, e cila nuk renditet ndër institucionet me përgjegjësi në SKMIM por që raporton gjenerimin e mbetjeve të caktuara prej veprimtarive ushtarake qoftë në terrenet e përcaktuara apo brenda njësisë ushtarake e porteve. Përfshirja e këtyre institucioneve do të ndihmojë jo vetëm në vlerësimin më të saktë sasior të sasisë së gjeneruar të mbetjeve, por edhe në alokimin e fondeve të buxhetit të shtetit për menaxhimin e tyre.

10. Të vlerësohet me përparësi puna për plotësimet ligjore dhe zbatimin e Përgjegjesisë së Zgjeruar të Prodhuesit, duke përfshirë aktorët e biznesit, krahas masave për të nxitur nismat e riciklimit sipas rrymave të caktuara në nivelin vendor.

11. Vlerësimi i ecurisë së zbatimit të SKMIM kërkon edhe rishikimin e një sërë treguesish të performancës, të cilët nuk mbështeten me të dhëna të grumbulluara në nivele të ndryshme. Tregues të tillë duhen riformuluar, nëse gjykohet i pamundur apo me kosto të lartë grumbullimi i të dhënave të monitorimit, ose duhet të nxiten institucionet përgjegjëse të grumbullojnë dhe raportojnë informacionin e nevojshëm për të vlerësuar ecurinë në bazë të këtyre treguesve.



## 8. SHTOJCA

# PYETËSOR

## PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË STRATEGJISË KOMBËTARE TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE

(VITI 2020)

**Drejtuar:**

Bashkisë: \_\_\_\_\_

**Kthim përgjigje:**

Lediana Karalliu, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit  
lediana.karalliu@turizmi.gov.al

**Afati i përgjigjes:**

30 Prill 2021

Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (SKMIM) dhe Plan Kombëtar i Veprimit (PKV) për periudhën 2020-2035 është miratuar në Maj 2020. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka filluar procesin e monitorimit të zbatimit të këtyre dokumentave strategjikë për vitin e parë 2020, dhe po përgatit vlerësimin vjetor të zbatimit kundrejt treguesve të performancës së miratuar në këtë Strategji dhe Plan Veprimi.

Përmes të dhënave të këtij pyetësori synojmë të vlerësojmë: a) efektivitetin e zbatimit të SKMIM dhe PKV 2020-2035 për vitin e parë 2020; b) efikasitetin e strukturave menaxhuese përgjegjëse për zbatimin e masave specifike; dhe c) të nxirren përfundime dhe rekomandime për të përmirësuar zbatimin e mëtejshëm të këtyre dokumenteve.

MTM dhe Grupi Teknik do të drejtojnë këtë proces me mbështetjen e programit të GIZ për "Modernizimin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta dhe riciklimit në Shqipëri".

Tiranë, Prill 2021

1. A është ngritur sistemi i dokumentimit, informimit dhe performancës të statistikave të gjenerimit, transferimit dhe trajtimit të mbetjeve në Bashkinë tuaj? [OS1-M1-1]

PO  JO

Mund të jepni informacion rreth cilësisë së të dhënave të grumbulluara, vështirësitë në raportim, sugjerime për përmirësim.

---

---

---

2. A ka Bashkia juaj në Plan Vendor për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (PVMIM)? [OS1-M3-4]

PO  JO

Nëse PO, kur është hartuar/miratuar?

Jepni disa reflektime mbi përmbushjen e objektivave vendore të planit: Arritje dhe vështirësi.

---

---

---

3. Sa është % e mbulimit me shërbimin e grumbullimit dhe transportimin e mbetjeve në Bashkinë tuaj? (% të numrit të banorëve) [OS2-M4-5]

Në cilat zonat nuk ka ende mbulim me këtë shërbim?

A ka pasur ndryshim në % e mbulimit gjatë vitit të fundit?

---

4. Sa është sasia e grumbulluar e mbetjeve në Bashkinë tuaj kundrejt sasisë së gjeneruar të mbetjeve? [OS2-M4-6]

A ka pasur ndryshim të raportit gjatë vitit të fundit dhe arsyt e ndryshimit?

---

5. Sa është % e popullatës në Bashkinë tuaj që mbulohe me shërbimin e integruar të mbetjeve?  
[OS2-M5-7]

A ka pasur ndryshim në numrin e banorëve që i është ofruar shërbimi i integruar i mbetjeve gjatë vitit të fundit?

6. A ka në territorin e Bashkisë juaj, qytet me më shumë se 100.000 banorë? [OS2-M5-8]

PO  JO

Nëse PO, sa % e popullësisë urbane mbulohe nga shërbimi i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (MIM).

A ka ndryshuar % gjatë vitit të fundit? Tregoni arsyet?

7. Sa % e mbetjeve shkojnë (për cdo rrymë) për riciklim, kundrejt sasisë totale të mbetjeve?  
[OS2-M5-9]

A ka ndryshuar % gjatë vitit 2020? Tregoni arsyet pse?

8. Sa është % e mbetjeve të tjera të rikuperuara nga mbetjet mikse, kundrejt totalit të mbetjeve?  
[OS2-M5-10]

Ka ndryshuar kjo % gjatë vitit 2020? Tregoni arsyet pse?

9. Sa është % e mbetjeve të paketimit të rikuperuara nga mbetjet mikse, kundrejt totalit të mbetjeve? [OS2-M5-11]

A ka ndryshuar kjo % gjatë vitit 2020? Tregoni arsyet pse?

10. Sa është sasia e mbetjeve të depozituara në landfill? [OS2-M5-12]

A ka ndryshuar kjo % gjatë vitit 2020? Tregoni arsyet pse?

11. A ka qendra pritëse për mbetjet në territorin e Bashkisë suaj, të ndara nga ato të prishjeve dhe të ndërtimit? [OS2-M5-13]

PO  JO

A janë ndërtuar qendra të reja pritëse në vitin 2020?

PO  JO

Nëse PO, sa qendra janë ndërtuar dhe si operojnë?

A keni planifikuar një qendër të tillë si te domosdoshme, por nuk keni pamundësi për ta ngritur?

12. A është ngritur në Bashkinë tuaj sistemi për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (MIM)? [OS2-M5-14]

PO  JO

Nëse Po, tregoni nëse është operacional apo në ndërtim? Vlerësoni shkallën e efikasitetit të tij dhe vështirësitë e ndeshura?

Nëse JO, a planifikoni ngritjen e një sistemi MIM në të ardhmen? Kur?

13. Sa është numri venddepozitimeve historike në territorin e Bashkisë suaj ku janë kryer ndërhyrje përmirësuese ose përmbyllëse gjatë vitit të fundit, kundrejt numrit total të venddepozitimeve historike të inventarizuara? [OS2-M6-15]

A keni plan të ndërhyrjeve për mbylljen e tyre? Tregoni periudhën kohore kur e planifikoni këtë proces.

14. A i dërgon Bashkia juaj mbetjet e pariciklueshme në ndonjë nga impijantet ËtE? [OS2-M7-16]

PO  JO

Nëse PO, tregoni vitin kur keni filluar dërgimin e këtyre mbetjeve?

15. Nëse i dërgoni mbetjet e pariciklueshme në një impjant ËtE, sa është sasia e mbetjeve të dërguara në ËtE në ton mbetje gjatë vitit të fundit? [OS2-M7-17]

16. A kryeni grumbullimin e mbetjeve nga paketimet në bazë të Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit? [OS2-M8-18]

Specifikoni llojin e mbetjeve të grumbulluara:

Nëse PO, a ka ndryshim në sasinë e grumbulluar gjatë vitit 2020 dhe cilët faktorë kanë ndikuar?

17. Në kuadër të Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit, a keni hartuar Plane Fizibiliteti për Zonat Mbetjeve, për rryma të vecanta mbetjesh, në qendra të përbashkëta apo të vecanta (për gomat, mbetjet elektrike, organike, makinat në fund të jetës)? [OS3-M9-19]

18. Cila është % e baterive dhe akumulatorëve që dërgohen në qendrat e pritjes dhe tërhiqen nga bizneset e licencuara? [OS3-M9-20]

A ka ndryshuar kjo % gjatë vitit 2020? Tregoni arsyet pse?

19. Cila është % e llumrave në impjantet e trajtimit të ujrave të përdorur, që trajtohen pranë tyre? [OS3-M9-21]

A ka ndryshuar kjo % gjatë vitit 2020? Tregoni arsyet pse?

20. Cila është % e mbetjeve inerte që grumbullohen në impjantet e trajtimit dhe ripërdoren?

A ka ndryshuar kjo % gjatë vitit 2020? Tregoni arsyet pse?

21. Në kuadër të Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit, a ka skema funksionale për rikuperimin dhe trajtimin e mbetjeve specifike? [OS3-M11-24]

PO       JO

Nëse PO, tregoni vitin kur keni filluar dërgimin e këtyre mbetjeve?

22. A është kryer ndonjë vlerësim për riorganizimin e sistemit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve [OS4-M14-27]

PO  JO

Nëse PO, thoni kur? Cfarë elementesh të rivlerësimit janë trajtuar.

23. A keni një rregullore të miratuar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve? [OS4-M15-28]

PO  JO

Nëse PO, thoni se kur është miratuar. A ka pasur ndonjë zhvillim në vitin 2020 lidhur me to?

24. Cili është niveli i buxhetit të dhëne nga Bashkia juaj për menaxhimin e mbetjeve, kundrejt nevojës për financim (në përqindje)? [OS5-M16-30]

A ka pasur ndryshim të vlerës në vitin 2020, krahasuar me vitet e mëparshme?

25. Cila është përqindja e shumës së të ardhurave të grumbulluara nga pagesa e tarifës kundrejt kostos totale të shërbimit? [OS5-M16-31]

A ka pasur ndryshim të vlerës në vitin 2020, krahasuar me vitet e mëparshme?

26. Sa % e tarifës për pastrimin mbledhet në nivelin e Bashkisë suaj, kundrejt planifikimit? [OS5-M16-32]

A ka pasur ndryshim të vlerës në vitin 2020, krahasuar me vitet e mëparshme?

27. Sa % të kostos për transportin dhe trajtimin e mbetjeve në objektet e trajtimit dhe depozitimit final mbulohen në nivelin e Bashkisë? [OS5-M17-33]

A ka pasur ndryshim të vlerës në vitin 2020, krahasuar me vitet e mëparshme?

28. Nëse Bashkia juaj i dërgon mbetjet në ËfE, sa % të kostos për transportin dhe trajtimin e mbetjeve në ËtE, mbulohet në nivelin e Bashkisë? [OS5-M17-34]

29. A ka njësi të specializuar për menaxhimin e mbetjeve pranë Bashkisë suaj? [OS7-M22-39]

PO  JO

Sa është numri i personelit të kualifikuar për këtë detyrë në institucion?

30. A ka pasur personel të kualifikuar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve gjatë vitit 2020? [OS7-M23-40]

PO  JO

Nëse Po, sa ka qenë numri i personave të kualifikuar?

31. A keni Plan të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të hartuar me pjesëmarrje qytetare? [os8-M25-43]

PO  JO

Nëse Po, a është hartuar gjatë 2020?

32. A ndahen mbetjet në burim në Bashkinë tuaj? [OS8-M25-44]

PO  JO

Nëse PO, sa është numri i banorëve që kanë ndarë mbetjet në burim gjatë 2020?

33. A keni organizuar veprimtari ndërgjegjësimi dhe pastrimi në Bashkinë tuaj gjatë vitit 2020? [OS8-M26-45]

PO  JO

Nëse po sa aktivitete të tilla, përshkruani ku dhe sa banorë kanë përfituar.

A ka pasur ndryshim në numrin e veprimtarive në vitin e fundit?

34. Sa është numri i shkollave në Bashkinë tuaj që kanë zhvilluar një kurrikul të edukimit mjedisor gjatë vitit 2020? [OS8-M27-46]

Nëse mund të jepni të dhëna për nivelin ku zhvillohet ky program mesimor (AMU, AML) dhe numrin e përafërt të nxënësve.

35. Sa shkolla në nivelin e Bashkisë suaj aplikojnë ndarjen e mbetjeve në burim? (si numër ndaj numrit të përgjithshëm) [OS8-M27-47]

\_\_\_\_\_

A ka pasur ndryshim në numrin e shkollave në vitin e fundit?

\_\_\_\_\_

36. Sa është sasia e pajisjeve elektrike të grumbulluara dhe të trajtuara? [OS9-M30-54]

\_\_\_\_\_

A ndonjë ndryshim gjatë vitit 2020?

\_\_\_\_\_

**JU FALEMINDERIT!**